



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit me Karakter Profesional në:

“Teknologji Ndërtimi”

“KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS”

Grupi i vlerësimit të jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Igli Kondi

2. Dr. Stela Sefa

Shkurt/ 2025

Tabela për programin e studimit me karakter profesional në :

“Teknologji ndërtimi”

h1	IAL aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës (KPT)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (DEMSA)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 699, datë 26.08.2015, botuar në fletoren zyrtare nr. 154, datë 02.09.2015
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	“Diplomë profesionale” në “Teknologji ndërtimi”
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA nr. 16, datë 02.03.2019
8	Cikli i studimit:	Niveli 5 sipas ligjit nr. 10 247, datë 04.03.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, të ndryshuar
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademikë (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 (ECTS):
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 sipas ligjit nr. 10 247, datë 04.03.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, të ndryshuar
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitin akademik: 2021 – 2022 – 10 PAE /14 PAK Për vitin akademik: 2022 – 2023 – 10 PAE /13 PAK Për vitin akademik: 2023 -2024 8 PAE /6 PAK
18	Numri i studentëve:	Për vitin akademik 2021 – 2022 – 0 studentë Për vitin akademik 2022 – 2023 – 7 studentë Për vitin akademik 2024 – 2025 – 0 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) është një institucion i arsimit të lartë, i licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 699, datë 26.08.2015. Kolegji Profesional i Tiranës, me adresë Rruga Xhanfize Keko, Kompleksi “Xhura”, Tiranë, Shqipëri, përbëhet nga dy departamente si njësi bazë dhe ofron 10 programe studimi.

Statuti i KPT, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”, është miratuar me Urdhërin e ministrit të linjës, nr. 147, datë 27.03.2018.

Hapja dhe licensimi i programit të studimi “Teknologji ndërtimi” është realizuar nëpërmjet VKM nr. 699, datë 26.08.2015. Njësia përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara. Programi i studimit “Teknologji ndërtimi” ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra) dhe është organizuar në bazë të sistemit të transferimit të krediteve në 120 ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë Profesionale në “Teknologji ndërtimi”, në përputhje me nivelin 5 të Kornizës së Kualifikimeve Shqiptare.

Qëllimi i këtij programi studimi është të përgatisë profesionistë në fushën e ndërtimit. Programi pajis studentët me njohuri të nevojshme për të konceptuar dhe zbatuar projekte të detajuara teknike në fushën e ndërtimit, për teknologjitë bashkëkohore, vetitë e materialeve, njohuri bazë për projektimin e strukturave të thjeshta betonarme dhe çeliku, etj.

Akreditimi i parë i programit të studimit “Teknologji ndërtimi” është bërë me vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 16, datë 02.03.2019, “Për akreditimin e parë të programit të studimit dy vjeçar me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, në “Teknologji ndërtimi”, për një afat pesë vjeçar.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) nisi punën e përbashkët, të ekspertëve të jashtëm dhe stafit të ASCAL, duke përcaktuar datën e vizitës në institucion, si edhe agjendën e takimeve. Në marrëveshje me IAL, vizitat në institucion u realizuan në datat 20 dhe 21 nëntor 2024.

GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit (DVV), të dorëzuar nga institucioni, përmes platformës ams.ascal.al dhe kredencialeve individuale të vlerësuesve të jashtëm. Burimi parësor i informacionit, për grupin e punës, ishte raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB), i përgatitur në tetor 2024. Ky raport ofron një pamje të detajuar të veprimtarisë që KPT ka ngritur për të përmbushur objektivat, standardet dhe kriteret specifike.

GVJ, **Prof. Asoc. Dr. Igli Kondi** dhe **Dr. Stela Sefa** gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialistja e ASCAL, Msc. Anilda Beqiraj. Takimet në institucion u realizuan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Përgjegjësin e Departamentit të Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Zyrës së Sekretarisë Mësimore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së Studentëve, përfaqësues të Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Sektorit të IT dhe Projekteve, dhe përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Kontratave. Gjithashtu u zhvillua një vizitë në auditorët, laboratorët dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime mbi infrastrukturën në dispozicion të programit të studimit.

GVJ kërkoi plotësim me disa materiale të nevojshme për vlerësimin përfundimtar, të cilat u plotësuan nga institucioni dhe u vendosën në platformën e ASCAL.

Raporti i GVJ është hartuar bazuar në gjetjet dhe konstatimet mbi programin e studimit dhe në zbatim të standardeve shtetërore të cilësisë.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI PARAARDHËS

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 16, datë 02.03.2019 janë:

Institucioni të shtojë në bibliotekë numrin e kopjeve fizike në funksion të këtij programi studimi.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm, diskutoi me rektorin e KPT, stafin akademik dhe përgjegjësën e bibliotekës lidhur me pasurimin e bibliotekës me libra, tekste mësimorë, revista shkencore, etj. Edhe nga bisedat, por edhe nga vizita në bibliotekë u konstatua se janë bërë përpjekje për të shkruar tekste mësimore nga stafi akademik për çdo lëndë dhe në përputhje me nivelin e studentëve. Por akoma, Biblioteka është e kufizuar si nga ana funksionale, ashtu edhe nga ana e përmbajtjes së literaturës bazë e ndihmëse për çdo lëndë.

GVJ konstaton se rekomandimi i kërkuar nga Bordi i Akreditimit në vendimin Nr. 16, datë 02.03.2019 është përmbushur kryesisht.

Kolegji Profesional i Tiranës është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 317/21, datë 12.12.2024. Institucioni njofton për komentet në ASCAL më datë 10.02.2025, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 190/5, datë 10.02.2025. *IAL s ka komente, drafti merr formën e raportit përfundimtar.*

Vlerësimi i programit të studimit me karakter profesional në “Teknologji ndërtimi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin bazë të dosjes së vetëvlerësimit (DVV), si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion (Protokoll i takimeve), GVJ konkludon që programi i studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi” ofron një kurrikul mësimore konkurruese, programe lëndësh të përditësuara, me nivel të mirë pedagogjik e shkencor, të mirëasimilueshëm, infrastrukturë e logjistikë të përshtatshme dhe cilësi produkti të kërkuar në tregun e punës e të mirëpritur nga nivelet e tjera të studimit profesional. Cilësia e këtij produkti dhe angazhimi i tij në përdorimin e njohurive të fituara është në përputhje të plotë me interesin kombëtar për të ndërtuar sa më shumë, sa më mirë e sa më lirë. Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi” është konceptuar në përputhje me vizionin e Kolegjit Profesional të Tiranës (KPT), sipas të cilit arsimi i lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi” ka funksionuar si i tillë qysh nga viti akademik 2015 – 2016. Produkti i tij tashmë ka identitet të qartë dhe është integruar plotësisht në komunitetin e profesionistëve në fushën e ndërtimit. Si i tillë, referuar RVB dhe planeve strategjike të KPT, ai ka dëshmuar se është në vazhden e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave teknike, shkencore dhe aplikative, praktike. Programi i studimit është ndërtuar si një urë lidhëse midis edukimit akademik dhe trajnimit profesional, duke lehtësuar integrimin e studentëve në tregun e punës dhe nxitur ata të ndjekin studimet universitare, nëpërmjet krijimit të njohurive të nevojshme praktike dhe krijimit të një baze të mjaftueshme teorike dhe shkencore për studimet universitare. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; plani mësimor, dokumenti 16; syllabuset, dokumenti 18)</i>

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	GVJ konsultoi jo vetëm kurrikulën aktuale dhe syllabuset e lëndëve, por edhe planet strategjike të institucionit dhe njësisë bazë. U gjet që ky program studimi (PS) është konkurren në kuadrin kombëtar dhe ka ambicien të mbetet i tillë në fushën e veprimtarisë. Në këtë perspektivë duket qartë që ky PS zhvillohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; plani mësimor, dokumenti 16; syllabuset, dokumenti 18; strategjia e zhvillimit të programit të studimit, dokumenti 19; rregullorja e KPT, dokumenti 12; statuti i KPT, dokumenti 10)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Referuar kurrikulës së këtij programi studimi, konstatohet që ajo është hartuar e tillë që të përgatisë një produkt sa më cilësor, ndërsa referuar angazhimit të produktit të këtij PS konstatohet, që ai ka kompetencën e duhur për të nxitur zhvillimin ekonomik kudo ku ai angazhohet. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; plani mësimor, dokumenti 16; syllabuset, dokumenti 18; strategjia e zhvillimit të programit të studimit, dokumenti 19; rregullorja e KPT, dokumenti 12; statuti i KPT, dokumenti 10)</i>
Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua gjetjeve në DVV, si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion. Nisur nga këto, GVJ konstaton që Institucioni i ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi”. Në DVV burimet, përvoja dhe kapacitetet e KPT paraqiten si më poshtë: <u>Burimet Infrastrukturore:</u> Mjedise për studentët (auditorë, klasa për leksione dhe seminare, laboratorë, ofiçina për kryerjen e disa provave, laboratorë informatike, bibliotekë, mjedise për fotokopjim/librari, zyra për informimin e studentëve, mjedise sociale dhe sportive); Mjedise për stafin (zyra, sallat e mbledhjeve, mjedise për personelin e shërbimit, mjedise çlodhëse). <u>Shërbime IT; Burimet njerëzore:</u> Numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik, me një përvojë të përshtatshme në disiplinat specifike të këtij programi studimi. Kolegji Profesional i Tiranës përbëhet nga 2 departamente: Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara Departamenti i Teknologjisë së Informacionit Në strukturën përbërëse të tij përfshihet edhe Departamenti i Elektro Mekanikës dhe i Sistemeve të Aplikuara, i cili është

	përgjegjës për programin e studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi”. Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang Kolegji (16 pedagogë) përbëhet nga: - 3 Profesorë Dr. - 1 MND - 12 Msc. Për vitin akademik 2023 – 2024, institucioni nuk ka angazhuar Personel Akademik me Kontratë Personeli Akademik Efektiv në rang departamenti, përgjegjës për programin e studimit (8 pedagogë), përbëhet nga: - 1 Profesor Dr. - 7 MSc Për vitin akademik 2023 – 2024, departamenti, përgjegjës për programin e studimit institucioni nuk ka angazhuar Personel Akademik me Kontratë (PAK). Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton ekzistencën dhe përdorimin me efektivitet si të përvojës ashtu edhe burimeve e kapaciteteve. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; të dhënat e stafit në vite, evidenca 6.1)</i>			
Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi” është në përputhje me fushën shkencore dhe aplikative të KPT, si edhe DEMSA. Nuk është kryer ende kodifikimi i lëndëve apo i programeve të studimit, pasi pritet miratimi nga MAS i propozimit të KPA, derguar me shkresën e datës 29.11.2022. <i>Referencë: DVV (Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor. Evidenca 5.3; Shkresa MAS për kodifikimin e programeve, Evidenca 8)</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, me fushën e veprimtarisë së tij, me interesat kombëtare, me ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, me strategjinë e KPT, bazuar në kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi DVV, si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton se në Kolegjin Profesional të Tiranës ka marrëdhënie bashkëpunimi funksionale midis të gjitha njësive bazë brenda institucionit. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe DEMSA, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë midis tyre. Në rastin konkret GVJ u informua për një sërë aktiviteteve me pjesëmarrjen e studentëve dhe të pedagogëve. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. GVJ nuk konstatoi shkresa zyrtare apo marrëveshje të shkruara që rregullojnë bashkëveprimin e brendshëm midis njësive bazë në KPT. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Përveç gjetjeve në DVV, lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendas e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e Zyrës së Informacionit, Mbështetjes dhe Karrierës, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet, duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Në strategjinë e institucionit për vitet 2021 – 2025, theksohet si prioritet shtimi dhe përmirësimi i marrëdhënieve ndërkombëtare (krijimi i raporteve të ngushta bashkëpunuese me institucionet e ngjashme në rajon dhe më gjerë), si edhe bashkëpunimi me bizneset. Aktualisht ka marrëveshje bashkëpunimi me katër IAL vendase në Shqipëri, të cilat janë: Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës,

	Universiteti European i Tiranës dhe Instituti Kanadez i Teknologjisë. KPT është pjesë e Konferencës së Rektorëve, si dhe merr pjesë në forumet e ndryshme të IAL-ve. KPT ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Thesalisë, Greqi, i cili ka për objekt shkëmbimin dhe zhvillimin profesional të stafit akademik dhe/ose administrativ, shkëmbimin e studentëve, bashkëpunimin në kërkimin shkencor, botime, etj. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion; Strategjia 2015 -2020, Evidenca 7.1; Strategjia 2021 – 2025, Evidenca 7; Lista e marrëveshjeve IAL, Evidenca 10; Aktiviteti Konferenca e Rektorëve, Evidenca 10.1; MoU_Uth, Evidenca 10.2; Lista e partnerëve /marrëveshjeve të bashkëpunimit, Evidenca 33; Panairi i punës, Evidenca 18/1)</i>
Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.	U kërkua informacion shtesë për këtë kriter. Rezultoi se KPT ka nënshkruar marrëveshje të lidhura vetëm për këtë program studimi, si me kompaninë Erli – D shpk, Segment shpk, Klemsi shpk, Gentalba shpk, Universi shpk, Institutin e Ndërtimit, etj. KPT organizon panairin e punës në ambientet e tij, me pjesëmarrjen e 100+ kompanive, institucioneve dhe organizatave më të mëdha që operojnë në tregun shqiptar në fusha të ndryshme për t’ju ofruar lidhje, mundësi të reja, punësim dhe internshipe profesionistëve të së ardhmes KPT ka marrëveshje bashkëpunimi me praktika.al., e cila është website më i madh i ofrimit të mundësive të internshipeve dhe praktikave profesionale për studentët dhe të sapodiplomuarit në kërkim të mundësive të shkëlqyera për të ngritur karrierat e tyre profesionale. Rregullorja e praktikave profesionale mbulon të gjitha aspektet e kryerjes së tyre dhe mënyrën e organizimit. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion; Strategjia 2015 -2020, Evidenca 7.1; Lista e marrëveshjeve IAL, Evidenca 10; Aktiviteti Konferenca e Rektorëve, Evidenca 10.1; MoU_Uth, Evidenca 10.2; Lista e partnerëve /marrëveshjeve të bashkëpunimit, Evidenca 33; Panairi i punës, Evidenca 18/1; Rregullorja e praktikave profesionale, Evidenca 5.1)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit	GVJ mësoi se në çdo fundviti akademik praktikat vlerësohen nga një komision i posaçëm dhe nga vetë studentët me anë të një formulari, nga i cili merret një informacion në lidhje me

harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	efektshmërinë e realizimit të praktikave. Departamenti harton raport analitik të përfitimit prej marrëveshjeve të bashkëpunimit. <i>Referencë: DVV (Raporti i praktikës profesionale, Evidenca 5.2)</i>			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Praktika profesionale shërben jo vetëm për aftësimin praktik dhe profesional në vendin e punës të studentit, por për njohjen e organizimit të punës së kompanisë. Studenti shikohet si një punëmarrës i mundshëm nga kompania ku ai kryen praktikën. KPT nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi punësimi, këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende si edhe për t'i asistuar në hyrjen dhe përshtatjen me tregun e punës <i>Referencë: DVV (Sondazhi alumni, Evidenca 12)</i>			
Konkluzione	<i>Për përmbushjen e këtij standardi GVJ konsultoi DVV, si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton se në Kolegjin Profesional të Tiranës ka marrëdhënie bashkëpunimi funksionale midis të gjitha njësive bazë brenda institucionit, ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi DVV, si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton se në Kolegjin Profesional të Tiranës janë ngritur strukturat përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe janë krijuar kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësimit dhe garantimit të cilësisë. Sigurimi

nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet piramidës hierarkike institucionale, akteve rregullatorë përkatës, si edhe nga njësia e sigurimit të cilësisë (NJSBC). Kryesisht NJSBC mbulon këto fusha, vlerëson dhe përmirëson programet dhe silabuset; ndjek ecurinë e zhvillimit të procesit akademik; kontrollon korrektësinë e realizimit të orarit të zhvillimit të orëve të mësimi; monitoron procesin e vlerësimit të pedagogëve për çdo lëndë nga ana e studentëve; ndjek mbarëvajtjen e zhvillimit të provimeve përfundimtare dhe cilësinë e korigjimit të tyre; vlerëson procesin e organizimit të praktikave profesionale dhe cilësinë e realizimit të tyre; monitoron sekretarinë mësimore; kontrollon vlerësimin e pedagogëve më të rinj nga ana e atyre më me përvojë. <i>Referencë: DVV (Statuti, Evidenca 3; Raporti i NJSBC, Evidenca 13.2; protokolli i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme, në strukturën organizative të KPT. Ajo funksionon në bazë të akteve rregullatorë të KPT, si statute, rregullorja e KPT, rregullorja e posaçme të funksionimit të NJSBC. Ajo ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Në përbërjen e NJSBC ka përfaqësues të stafit akademik, administratës, një përfaqësues nga studentët dhe një ekspert të jashtëm, me synimin për të pasur profesionalizëm, transparencë të plotë dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë. Çdo fillim viti akademik NJSBC miraton një plan pune mbi mbikëqyrjen dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë akademike dhe administrative të KPT, duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për anëtarët e saj. <i>Referencë: DVV (Statuti, Evidenca 3; Raporti i NJSBC, Evidenca 13.2; protokolli i takimeve gjatë vizitës në institucion; Vendimi i ngritjes së NJSBC, Evidenca 13; Rregullorja e NJSBC, Evidenca 13.1)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të	Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, KPT i nënshtrohet vlerësimit periodik institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Akreditimi i parë institucional është kryer në vitin 2017. Kolegji Profesional i Tiranës u akreditua si institucion i arsimit të lartë me Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 66, datë 21.09.2017 “Për akreditimin e parë të institucionit të

akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	arsimit të lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”, proces i cili u realizua nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë e Garantimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar (Institucione të Akredituara (ascal.al). Programet e studimit të KPT kanë kaluar akreditimin e parë dhe disa prej tyre i janë nënshtruar procesit të akreditimit periodik. <i>Referencë: DVV (Statuti, Evidenca 3)</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	Institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të tjerë. Nga ana tjetër, institucioni është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar marrëveshje me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit si Erasmus + CBHE USIA, WP5 “Second a researcher”, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse. Gjithashtu, institucioni promovon shembujt e praktikave më të mira përmes mjeteve të tij të komunikimit siç janë emaili ose faqja e internetit. <i>Referencë: DVV (Statuti, Evidenca 3; Politika e kërkimit të aplikuar në KPT, Evidenca 19; protokolli i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>			
Konkluzione	Në Kolegjin Profesional të Tiranës janë ngritur strukturat përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe janë krijuar kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësimit dhe garantimit të cilësisë. Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi” është i strukturuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra të rregullt. Zhvillohen gjithsej 21 lëndë të ndara sipas 2 viteve shkollorë (12 lëndë në vitin e parë; 9 lëndë në vitin e dytë). Në 21 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika profesionale. Lëndë të detyrueshme janë 21. Lëndë me zgjedhje janë 0. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi” është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban afërsisht 30 ECTS. Sasia totale e krediteve është 120. Bazuar në rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. <i>Referencë: DVV (Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Planin mësimor, Evidenca 5.3)</i>

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.	Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit “Teknologji ndërtimi” siguron formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjerë specialitetesh, të përshtatshme për ambiente të ndryshme pune. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike. <i>Referencë: DVV (Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3)</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Lëndët e parashikuara të zhvillohen në programin e studimit “Teknologji ndërtimi” janë të larmishme. Fillohet me anglisht vazhdohet me matematikë, fizikë, teknologji ndërtimi, vizatim teknik e autocad e deri tek Materiale inxhinierike dhe metrologjia, Struktura betoni, çeliku dhe druri, Ndërtime infrastrukturore, Llogaritja dhe analiza e kostove në ndërtim, etj. Si pasojë programi ofron njohuri të përparura, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës ashtu edhe të njohurive praktike e aplikative. <i>Referencë: DVV (Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Në kategorinë A bëjnë pjesë 3 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 9 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë E bëjnë pjesë 1 lëndë. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje: • kategoria A – 15 ECTS – 12.50% • kategoria B – 54 ECTS – 45.00% • kategoria C – 24 ECTS – 20.00% • kategoria D – 20 ECTS – 16.66% • kategoria E – 7 ECTS – 5.84%

	Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt. Bëjnë përjashtim lëndët e kategorisë C, për të cilat VKM 879 parashikon kredite në masën (5 – 15) %, lëndët e kategorisë D, për të cilat parashikohet një sasi kreditesh (10 – 15)% të sasisë totale të krediteve, ndërsa për lëndët e kategorisë E parashikohet një sasi kreditesh në masën (3 – 5)% të sasisë totale të tyre. <i>Referencë: DVV (Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3)</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Sipas gjykimit të GVJ elementët e programit të studimit “Teknologji ndërtimi” në përgjithësi janë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019. Kurrikula dhe programet e lëndëve të programit të studimit në përgjithësi janë në përputhje me VKM-ët e mësipërme. Programi i studimit “Teknologji ndërtimi” është një program studimi i nivelit 5 të KSHK. Ka një kohëzgjatje normale prej dy vitesh akademikë dhe plotësohet me 120 ECTS. Forma e studimeve të programit të studimit “Teknologji ndërtimi” është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe. Pas përfundimit të kërkesave për diplomim nga programi i studimit në fjalë, studentit i lëshohet diploma përkatëse. Politikat dhe procedurat e pranimi dhe të përzgjedhjes së studenteve bazohen përgjithësisht në kriteret ligjore të përcaktuara nga organet shtetërore dhe aktet përkatës, duke i përshtatur në aktet rregullatore dhe vendimmarrjet e autoriteteve drejtuese të KPT, duke marrë në konsideratë kapacitetet në infrastrukturë, burime, njerëzore dhe kërkesat e tregut. <i>Referencë: DVV (Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3; Vendimet e SA për kuotat e pranimi për cdo vit akademik, Evidenca 23)</i>
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	KTP nuk ka program tjetër me një emërtesë dhe që i përketin të njëjtës fushë studimi, përveç programit të studimit “Teknologji ndërtimi”. <i>Referencë: DVV (Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3)</i>

Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Me daljen e akteve përkatëse, nënligjore, KPT ka ndërmarrë procesin e kodifikimit të programeve të studimit që ofron. Propozimet janë dërguar për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. <i>Referencë: DVV (Shkresa MAS për kodifikimin e programeve, Evidenca 8 protokollit i takimeve gjatë vizitës në institucion).</i>			
Konkluzione	Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit "Teknologji ndërtimi" siguron formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjere specialitetesh të përshtatshme për ambiente të ndryshme pune. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Kolegji Profesional i Tiranës përbëhet nga 2 departamente: 1. Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara; 2. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang Kolegji (16 pedagogë) përbëhet nga: - 3 Profesorë Dr. - 1 MND - 12 Msc. Për vitin akademik 2023 – 2024, institucioni nuk ka angazhuar Personel Akademik me Kontratë Personeli Akademik Efektiv në rang departamenti, përgjegjës për programin e studimit (8 pedagogë), përbëhet nga: - 1 Profesor Dr. - 7 MSc Departamenti i Elektro Mekanikës dhe i Sistemeve të Aplikuara, i cili është përgjegjës për programin e studimit me

	karakter profesional “Teknologji Ndërtimi” përbëhet nga: Për vitin akademik 2023 – 2024: - 1 (një) Lektor me titullin Prof Dr. - 7 (shatë) Asistentë Lektorë me gradën MSc Për vitin akademik 2022- 2023: - 2 (dy) Lektor me titullin Prof Dr. PAE dhe - 8 (tetë) Asistentë Lektorë me gradën MSc. Për vitin akademik 2021- 2022: - 2 (dy) Lektor me titullin Prof Dr. - 8 (tetë) Asistentë Lektorë me gradën MSc. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton ekzistencën dhe përdorimin me efektivitet si të përvojës ashtu edhe burimeve e kapaciteteve. Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; të dhënat e stafit në vite, evidenca 6.1)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Në funksion të veprimtarisë së njësive bazë janë sekretaria mësimore dhe stafi administrativ, të cilët bashkërendojnë punën e tyre për realizimin sa më efikas të proceseve të ndryshme brenda departamentit. Nga biseda me drejtuesin e DEMSA rezulton se nuk është angazhuar personel ndihmës akademik për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; të dhënat e stafit në vite, evidenca 6.1; protokollin e takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazuar ne RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se janë caktuar dy pedagogë si koordinatorë, një për çdo departament. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; të dhënat e stafit në vite, evidenca 6.1; protokollin e takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Konkluzione	Bazuar ne RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se DEMSA përmbush kryesisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë përkatës, pasi

	mungon personeli akademik ndihmës për laboratorët dhe praktikantët mësimorë e profesionalë. GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	DEMSA zotëron informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit “Teknologji ndërtimi” Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, plani strategjik i KPT, statuti, rregullorja e institucionit, etj. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të institucionit dhe të aksesueshme nga të gjithë. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion; Statuti, Evidenca 3; Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, Evidenca 5.6; Strategjia 2021 - 2025, Evidenca 7; Rregullorja e praktikave profesionale, Evidenca 5.1; Rregullorja e KPT, dokumenti 12)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit “Teknologji ndërtimi” është i strukturuar në 2 vite shkollorë dhe 4 semestra. Zhvillohen gjithsej 21 lëndë (120 ECTS), të ndara sipas 2 viteve shkollorë (12 lëndë në vitin e parë; 9 lëndë në vitin e dytë). Në 21 lëndët, që parashikohen në planin mësimor, përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika. Lëndë të detyrueshme janë 21. Lëndë me zgjedhje nuk janë parashikuar. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Nuk është parashikuar ndarja e lëndëve në module. Në kategorinë A bëjnë pjesë 3 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 9 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë E bën pjesë 1 lëndë. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e

	kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje: kategoria A – 15 ECTS – 12.50% kategoria B – 54 ECTS – 45.00% kategoria C – 18 ECTS – 16.66% kategoria D – 26 ECTS – 20.00% kategoria E – 7 ECTS – 5.84% Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt. Bëjnë përjashtim lëndët e kategorisë C, për të cilat VKM 879 parashikon kredite në masën (5 – 15) %, lëndët e kategorisë D, për të cilat parashikohet një sasi kreditesh (10 – 15) % të sasisë totale të krediteve, ndërsa për lëndët e kategorisë E parashikohet një sasi kreditesh në masën (3 – 5) % të sasisë totale të tyre. Programi i studimit “Teknologji ndërtimi” është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranim, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit me karakter profesional “Teknologji ndërtimi” duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranim, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. Institucioni, nëpërmjet zyrës së pranimeve, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranim, transfer të dhe njehsim studimesh. Të gjitha informacionet janë bërë publike dhe vënë në dispozicion të publikut në ambientet e institucionit, si dhe janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit. Kriteret e pranim në KPT miratohen me vendim të Senatit Akademik, depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe publikohen rregullisht në faqen e internetit të KPT dhe në rrjetet sociale të KPT. Gjithashtu Rregullorja e KPT, neni 24, neni 31, jep informacionin dhe kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve, informacionet e nevojshme lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3;</i>

	<i>Rregullorja KPT, Evidenca 4, Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5)</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë. Silabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturën kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxëniet të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3)</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.	KPT përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni. Para fillimit të çdo viti akademik zhvillohen takime pune për të parë nevojën e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit. Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga departamenti përkatës. Vendimet për rishikimin e kurrikulave merren mbi bazën e propozimeve të njësive bazë. Pas kësaj vendimet e njësive bazë kalojnë për miratim në senat. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3); Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, Evidenca 5.6; Strategjia 2021 - 2025, Evidenca 7;</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar ne RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit "Teknologji ndërtimi" është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, anglisht, vizatim teknik, etj. Më tej kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Në semestrin e dytë të vitit të parë dhe në vitin e dytë zhvillohen lëndë të mirëfillta inxhinierike, që përfshijnë studimin dhe zbatimin e parimeve të ndërtimit. Studentët zhvillojnë laboratore në lëndë të ndryshme, praktikë profesionale, si edhe njihen me përdorimin e programeve kompiuterike inxhinierike. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3)</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, anglisht, vizatim teknik, etj. Në semestrin e dytë të vitit të parë dhe në vitin e dytë zhvillohen lëndë të mirëfillta inxhinierike, që përfshijnë studimin dhe zbatimin e parimeve të ndërtimit. Një perceptim i fortë i parimeve praktike dhe fizike nxitet dhe promovohet, duke ofruar një bollëk mundësish mësimnxënieje. Përgjatë programit, studentëve u ofrohen mundësi që të përforcojnë aftësitë e tyre grafike dhe të komunikimit me gojë. Semestri i dytë i vitit të parë dhe viti i dytë përbëhen kryesisht nga lëndë themelore të profesionit, që përfshijnë studimin dhe zbatimin e parimeve të inxhinierisë së ndërtimit (mekanika e dherave dhe e themeleve, struktura betoni, çeliku dhe druri, ndërtime infrastrukturore, etj.) Në të njëjtën kohë, zbatimi praktik i njohurive paraqitet dhe zbatohet përmes detyrave të kursit dhe projekteve. Studentëve iu ofrohen njohuri menaxheriale, si edhe kryerja e një praktike të zgjatur në kohë përgjatë semestrit të dytë. Për më tepër, studenti sfidohet duke parë rolin e tij nga një këndvështrim ndërdisiplinor dhe multidisiplinor. Zhvillohet gjithashtu roli i ndërtuesit si menaxher. Për të zhvilluar më tej aftësitë profesionale programi i studimit përfundon me plotësimin e një praktike

	profesionale. Nga sa më sipër rezulton se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3; Syllabus, Evidenca 5.5)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Bazuar në planin mësimor, rezulton se 12 lëndë i përkasin formimit teorik dhe 9 lëndë i përkasin aftësimit praktik profesional. Gjithsesi edhe brenda lëndëve teorike parashikohen laboratorë apo praktika. Duke i llogaritur kreditet përkatës rezulton se i takojnë 43 kredite (35.9%) formimit teorik dhe 77 kredite (64.1%) aftësimit praktik, profesional. Një raport i tillë është shumë i mirë dhe përbën sukses për programin e studimit. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Plani mësimor, Evidenca 5.3; Syllabus, Evidenca 5.5)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Plani mësimor i programit të studimit “Teknologji ndërtimi” parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme inxhinierike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një kompani ndërtimi. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se praktikat profesionale të studentëve përbëjnë një anë pozitive të programit të studimit. Kompani të ndryshme partnere i ofrojnë studentëve të këtij programi studimi mundësi të kryerjes së praktikave cilësore, gjatë të cilave studentët ndeshen me situata konkrete pune, duke dhënë kontributin e tyre real në kryerjen e punëve të mirëfillta të fushës së ndërtimit. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Plani mësimor, Evidenca 5.3; Syllabus, Evidenca 5.5; protokoll i takimeve</i>

	<i>gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.	Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, konsultohen dhe miratohen nga drejtuesi i departamentit. Si rregull programet e lëndëve/moduleve bazohen në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3; Syllabus, Evidenca 5.5; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se praktikat profesionale të studentëve përbëjnë një anë pozitive të programit të studimit. Kjo në saj të bashkëpunimit të ngushtë me kompani të ndryshme të fushës, të cilat i ofrojnë studentëve të këtij programi studimi mundësi të kryerjes së praktikave cilësore, gjatë të cilave studentët ndeshen me situata konkrete pune, duke dhënë kontributin e tyre real në kryerjen e punëve të mirëfillta të fushës së ndërtimit. Studentët kontaktojnë personalisht dhe zgjedhin kompaninë ku do të kryejnë praktikën, e cila ndiqet nga një mbikqyrës i KPT dhe një inxhinier i kompanisë pritëse. Studenti paraqet para komisionit, të përbërë nga tre vetë, relacionin përkatës. Njëri nga anëtarët e komisionit është drejtuesi i departamentit. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3; Syllabus, Evidenca 5.5; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	Përmbajtja e programit të studimit "Teknologji ndërtimi" i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin 5 të KSHK, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar universitar, si dhe, mbi të gjitha, duke krijuar dije dhe kompetanca profesionale në përputhje me pritshmëritë e tregut të punës. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve universitare dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; Plani mësimor, Evidenca 5.3; Syllabus, Evidenca 5.5; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Konkluzione	<i>Rezulton se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra,</i>

	vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional. Përmbajtja e programit të studimit i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin 5 të KSHK, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar universitar, si dhe, mbi të gjitha, duke krijuar dije dhe kompetenca profesionale në përputhje me pritshmëritë e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Përveç gjetjeve në DVV, lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendës e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e zyrës së projekteve e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet, duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Mbledhje e Asamblesë së Personelit, Evidenca 9; USIA roundtable, Evidenca 11.3.)</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	KPT krijon mundësitë reale për përfshirjen e studentëve në vendimmarrjen e organeve drejtuese të tij dhe shprehjen e organizuar të mendimit të tyre. Këshilli i studentëve është organizëm i pavarur i studentëve të KPT, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët dhe përfaqëson interesat e tyre.. Këshilli i studentëve shpreh mendime dhe propozime për probleme me interes të përgjithshëm të Kolegjit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Gjatë bisedës me studentët

	ata shprehën lirisht mendimin e tyre pozitiv në lidhje me përfshirjen aktive dhe efektive të tyre në jetën akademike dhe jo vetëm të KPT. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Statuti i KPT, Evidenca 3; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	Institucioni përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga KPT. Para fillimit të çdo viti akademik zhvillohen takime pune për të parë nevojën e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit. Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga departamenti përkatës. Vendimet për rishikimin e kurrikulave merren mbi bazën e propozimeve të njësive bazë. Pas kësaj vendimet e njësive bazë kalojnë për miratim në këshillin e fakultetit dhe në senat. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; USIA roundtable, Evidenca 11.3.; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>			
Konkluzione	<i>KPT krijon mundësitë reale për përfshirjen e studentëve në vendimmarrjen e organeve drejtuese të tij dhe shprehjen e organizuar të mendimit të tyre. KPT bashkëpunon me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendës e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi														
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, ushtrimet, labororet, praktikat mësimore e profesionale, provimin përfundimtar. Ndarja e tyre në program është si më poshtë: <table> <tr> <td>Leksione</td><td>49/50 kredite, 343/350 orë mësimore</td></tr> <tr> <td>Ushtrime</td><td>38 kredite, 456 orë mësimore</td></tr> <tr> <td>Laborator/Praktikë</td><td>27/25 kredite, 567/525 orë mësimore</td></tr> <tr> <td>Tema/Provimi formimi</td><td>7 kredite, 12 orë mësimore</td></tr> <tr> <td>Orë në auditorë</td><td>1345 orë mësimore</td></tr> <tr> <td>Punë individuale e st.</td><td>1655 orë mësimore</td></tr> <tr> <td>Gjithsej</td><td>3000 orë mësimore</td></tr> </table> Përveç kësaj DEMSA organizon edhe leksione të hapura me ekspertë të fushës. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Plani mësimor, Evidenca 5.3)</i>	Leksione	49/50 kredite, 343/350 orë mësimore	Ushtrime	38 kredite, 456 orë mësimore	Laborator/Praktikë	27/25 kredite, 567/525 orë mësimore	Tema/Provimi formimi	7 kredite, 12 orë mësimore	Orë në auditorë	1345 orë mësimore	Punë individuale e st.	1655 orë mësimore	Gjithsej	3000 orë mësimore
Leksione	49/50 kredite, 343/350 orë mësimore														
Ushtrime	38 kredite, 456 orë mësimore														
Laborator/Praktikë	27/25 kredite, 567/525 orë mësimore														
Tema/Provimi formimi	7 kredite, 12 orë mësimore														
Orë në auditorë	1345 orë mësimore														
Punë individuale e st.	1655 orë mësimore														
Gjithsej	3000 orë mësimore														
Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Mësimdhënia në KPT rezulton e larmishme, në varësi të specifikave të lëndëve dhe nevojave të studentëve. Ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht nivelit të përgatitjes së tyre. Format e mësimdhënies mbajnë parasysh rezultatet e vlerësimeve të ndryshme, të kryera herëpashere. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Plani mësimor, Evidenca 5.3; protokollin e takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>														
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të	Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe ëorkshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Nga ana tjetër, DEMSA ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe fleksibile përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarët, studentët														

studentëve.	marrin pjesë në punën laboratorike, japin detyra kursi, zhvillojnë prezantime etj. Departamenti ka organizuar disa aktivitete me përfaqësuesit e industrisë së ndërtimit për të kuptuar më mirë pritshmëritë e tregut. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Plani mësimor, Evidenca 5.3; protokoli i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Ky vlerësim fillon që në fazën e rekrutimit. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës. Nga ana tjetër, personeli akademik i DEMSA përmirësohet vazhdimisht, duke marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe aktivitete trajnimi, si dhe organizon aktivitete trajnimi brenda departamentit. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; protokoli i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nëpërmjet mënyrave të ndryshme (të shpjeguara në RVB) institucioni thith mendimet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me problematikat e procesit mësimor. Pas kësaj drejtuesi i departamentit kryen verifikimet e duhura dhe propozon masat përkatëse, të cilat konsistojnë në ndryshimin e rregulloreve apo të zëvendësimit të pedagogut, i cili nuk e ka kompetencën e duhur profesionale dhe didaktike. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; protokoli i takimeve gjatë vizitës në institucion; Formularët e vlerësimit Studentë, Evidenca 15; Fokus Grupe, Evidenca 16; Tutoriatet/ këshillimi akademik, Evidenca 17)</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të	Brenda KPT është ngritur dhe funksionon NJSBC, e cila është njësi autonome, operative, e përhershme e institucionit. Sigurimi i brendshëm i cilësisë garanton cilësinë e veprimtarisë së institucionit, që ajo të kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera rregullatore, si edhe në përputhje me vizionin, misionin dhe objektivat e KPT. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, formuese e trainuese, administrative e financiare të KPT, si dhe propozon

përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	ndryshime për përmirësimet e nevojshme. Për ushtrimin e funksioneve të saj, NJSBC-ja ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Mënyra e funksionimit të NJSBC-së rregullohet me rregullore të veçantë. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7: protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion; Rregullore NJSBC, Evidenca 13.1; Raporti NJSBC, Evidenca 13.2.)</i>			
Konkluzione	Mësimdhënia në KPT rezulton e larmishme, në varësi të specifikave të lëndëve dhe nevojave të studentëve. Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike. Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Nëpërmjet mënyrave të ndryshme institucioni thith mendimet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me problematikat e procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjithçka i bëhet e qartë studentit gjatë javës së orientimit, si edhe nga pedagogët e lëndëve. Mënyra e vlerësimit është rubrikë e çdo syllabusi, dhe pedagogu jep udhëzimet përkatëse në auditor në fillim të zhvillimit të lëndës. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo	Para fillim të procesit mësimor, për studentët ofrohet java e

lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	orientimit. Studentët pajisen me Manualin e Studentit, Manualin Classter, me rregulloren përkatëse të programit të studimit, që përmbajnë informacion, përfshirë këtu edhe metodat e vlerësimit të njohurive të tyre. Gjithashtu ky informacion gjendet në Classter si dhe fizikisht në ambientet e shkollës. Informacioni sqarohet edhe gjatë javës orientuese të fillimit të vitit akademik, si dhe nga çdo pedagog për lëndën e tij. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5; Java e Orientimit, Evidenca 30, Manuali i studentit, Evidenca 27; Manuali Classter, Evidenca 28)</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	Mbështetur në rregulloren e KPT, në rregulloren e PS, në rregulloren mësimore, si edhe në manualin e studentit, metodat e testimit janë provimi përfundimtar, kolokiume, detyra kursi, laboratorë, ushtrime, seminare, etj. Në përfundim të praktikës profesionale studenti përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojën në subjektin pritës, i cili paraqitet dhe mbrohet para një komisioni. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5; Manuali i Studentit, Evidenca 27; Rregullorja e praktikave profesionale, Evidenca 5.1)</i>			
Konkluzione	<i>Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Studentët pajisen me Manualin e Studentit, Manualin Classter, me rregulloren përkatëse të programit të studimit, që përmbajnë informacion, përfshirë këtu edhe metodat e vlerësimit të njohurive të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe	Bazuar në shqyrtimin e silabuseve të lëndëve në programin studimor, në rregulloren e PS, si edhe në bisedat me

aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	studentët, njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes këtyre formave kryesore: 1) detyra praktike, 2) detyra kursi, 3) provimet e lëndëve, 4) provimi përfundimtar, 5) prezantime. Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të PS konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Janë përcaktuar periudha kohore të dedikuara për provimet, provimet e ndërmjetëm dhe provimet përfundimtare. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sisteme elektronike të testimit janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë. Me kalimin e kësaj periudhe testimi i studentëve kryhet me metoda klasike. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi i përgatitjes së studentit kryhet në vazhdimësi gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultat i elementëve të mëposhtëm: • Provimi përfundimtar (60%) • Kolokiume/ projekte/laboratore (30%) • Aktivizimi në ushtrime (10%) <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5; Syllabus, Evidenca 5.5).</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pike/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi. Gjatë takimit me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv mbi komentet, keshillat dhe rekomandimet e pedagogeve në mënyrë që të ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Kolegji Profesional i Tiranës gjatë procesit të provimeve/testimit të njohurive organizon një manaxhim të mbikqyrjes së studentëve, duke monitoruar procesin e testimeve. Monitorimi i zhvillimit të provimeve është një proces kyç për institucionin, pasi garanton një proces cilësor, të qetë dhe të rregullt, duke shmangur kopjimin dhe prishjen e rregullit. Plagjiatura e provuar në paraqitjen e detyrës së kursit, punës së laboratorit dhe të diplomës ndëshkohet me

	marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare në disiplinën ose veprimtarinë formuese përkatëse, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4)</i>			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura. Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritën e studentëve. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5)</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga shqyrtimi i rregulloreve, si dhe gjatë vizitës në institucion u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi. duke paraqitur një ankesë në departament. Ankesa paraqitet në formën e një formulari të veçantë, brenda një jave pas shpalljes së notave përfundimtare. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5)</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Me marrjen e ankesës, drejtuesi i departamentit ose rektori, kur pedagogu i lëndës është vetë drejtuesi i departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5)</i>			
Konkluzione	Nga shqyrtimi i rregulloreve, si dhe gjatë vizitës në institucion u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankesë në departament. Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të PS konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Vlerësimi është transparent dhe në përputhje me meritën e çdo studenti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Përmbajtja e programit të studimit “Teknologji ndërtimi” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e 5-të kornizës shqiptare të kualifikimit, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar universitat dhe për aftësimin profesional e teknik të studentëve. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë-kurrikulare, siç janë forume të hapura, vizita në terren, konferenca studentore, praktika profesionale, etj. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e Programit të Studimit, Evidenca 5; Strategjia e zhvillimit të programit, Evidenca 5.6)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Për të përmbushur këtë kriter në planin mësimor të PS përfshihen lëndë të tilla si “Hyrje në teknologjinë e informacionit”, “Anglisht”, etj. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Plani mësimor, Evidenca 5.3)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e çdo lënde, analizohen në përfundim të semestrit akademik. Pedagogët tërheqin mendimin e studentëve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të përmbajtjes së lëndëve. Si një test për të kuptuar se sa kanë përfituar studentët shërben edhe detyra praktike. Në përfundim të çdo lënde pedagogu thekson problemet më të rëndësishme, të cilat do t’u nevojiten studentëve, duke i këshilluar ata për mënyrën e implementimit të tyre. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Plani mësimor, Evidenca 5.3; Silabus, Evidenca 5.5)</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpercaktuara në programet lëndore. Studentët e programit “Teknologji ndërtimi” kanë në dispozicion

studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët e inxhinierisë së ndërtimit, si dhe në praktikat profesionale. Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit të studimit “Teknologji ndërtimi”. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Plan i mësimor, Evidenca 5.3; Silabus, Evidenca 5.5)</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon workshope, si dhe zhvillon aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Takime me biznese, Evidenca 30; Prezantimet në departament, Evidenca 49)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore. Përmbajtja e programit të studimit “Gjeodezi” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e 5-të kornizës shqiptare të kualifikimit, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar universitat dhe për aftësimin profesional e teknik të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton	Rregullorja e KPT dhe e programit të studimit kanë të

procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	specifikuar detyrimet përmbyllëse që ka studenti. Këto detyrime i komunikohen studentit paraprakisht nëpërmjet email-it. Studenti duhet të përgatisë dhe të dorëzojë, punime të punëve të laboratorëve, mbrojtja e praktikës profesionale (dorëzimi i materialit / prezantimi në power point dhe plotësimi i formularëve) përpara procesit të provimeve semestrale apo përfundimtare. Praktikrat profesionale vlerësohen me nota, njëjloj si detyrimet e tjera. Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare ndaj KPT, fiton të drejtën e marrjes së diplomës. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Mbrojtja bëhet përmes dhënies së një provimi të përgjithshëm përfundimtar. Për studentët me notë mesatare mbi 8.5 përgatisin një diplomë. Në provimin final përfshihen 6 lëndë. Për këtë provim hartohet një program, i cili i dorëzohet studentëve dhe mbi bazën e të cilit hartohet teza e provimit. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja KPT, Evidenca 4)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Personeli akademik, në ndihmë të studentëve, ka përgatitur tekste mësimore në përputhje me nivelin e studentëve. Për provimin e formimit përmbyllës është përgatitur një program i posaçëm, ku përfshihen 6 lëndë. Mbi bazën e këtij programi përgatitet teza e provimit. Para provimit studentevë iu vihen në dispozicion takime sqaruese dhe konsultime. Orët e laboratoreve dhe praktika profesionale i shërbejnë pikërisht përgatitjes sa më të mirë të studentëve, krijimit tek ata të njohurive teknike të qendrueshme edhe në funksion të detyrimeve përmbyllëse. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja KPT, Evidenca 4)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Gjatë përgatitjes së procesit të zhvillimit të provimit përfundimtar, Departamenti, duke u bazuar në rregulloren e programit të studimit “Teknologji ndërtimi”, shqyrton specifikat e këtij programi, planet mësimore dhe syllabuset më të përshtatshme, me qëllim që të evidentohen lëndët themeltare, që duhet të përmbajë provimi përfundimtar, në përputhje me profilin e PS. Më tej në bashkëpunim me stafin akademik, i cili është përgjegjës për mbulimin e këtyre lëndëve, hartohet teza. Provimi përfundimtar është i ndërtuar nga 6 sesione pyetjesh përkatësisht për 6 lëndë të ndryshme. Rëndësia dhe pesha e secilës lëndë, në provimin

	përfundimtar, përcaktohet me bazë përqindjeje dhe total pikësh të shpërndara për cdo pyetje. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Programi dhe Model teze PPP, Evidenca 50)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në studimin e RVB, si edhe nga biseda me drejtuesin e DEMSA, rezulton se institucioni parashikon për studentët me notë mesatare më të lartë se 8.5 punimin e diplomës. Për tjerët provimin mbyllës, përfundimtar. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Programi dhe Model teze PPP, Evidenca 50)</i>
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Kurrikula mësimore është një kombinim i teorisë dhe praktikës, e cila kryesisht zhvillohet në ambientet e KPT (laboratorët) dhe pranë bizneseve/institucioneve përkatëse, ku studentët shoqërohen nga pedagogu përkatës. Në vitin e dytë studentët zhvillojnë praktikat profesionale (6 javore) pranë bizneseve/institucioneve, që lidhen me fushën e veprimtarisë së programit të studimit. Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga drejtuesi i DEMSA, në bashkëpunim me Zyrën e Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve. Praktika është kusht i detyrueshëm për të përfunduar studimet. Lënda e praktikës që zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë ka një ngarkesë prej 10 kreditesh. Studenti i cili nuk shlyen praktikën profesionale nuk ka të drejtë të diplomohet. Drejtuesi i njësisë bazë përcakton pedagogët, të cilët do të ndjekin studentët në zhvillimin e praktikës. Institucioni pritës ofron mbikëqyrës për realizimin e procesit të mbrojtjes së praktikave profesionale. Vlerësimi i studentëve përcaktohet nga tre komponentë. • Vlerësimi i pedagogut që ndjek praktikën profesionale. • Pjesëmarrja dhe aktivizimi i studentëve në kompani

	gjatë zhvillimit të praktikës. • Relacioni përfundimtar i praktikës i cili vlerësohet nga komisioni. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; Rregullorja e praktikave profesionale, Evidenca 5.1; Raporti i praktikave, Evidence 5.2; Laboratorët, Evidenca 22)</i>
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	Rregullorja e KPT ka të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes dhe vecanërisht të provimeve e riprovimeve që stafi akademik dhe student duhet të ndjekin. Këtu përfshihen procedurat që duhen ndjekur, rregullat e hartimit të tezave, monitorimi dhe sekretimi i provimeve, e drejta e studentit për të hyrë në provim ose jo, vlerësimi i studentëve. Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 7; Rregullorja e KPT, Evidenca 4)</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Certifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Programet e studimit jouniversitare, profesionale, realizohen me 120 kredite. Kohëzgjatja normale është 2 vite akademike (4 semestra) dhe në përfundim të tyre do të lëshohet “Diplomë Profesionale” në fushën e arsimimit të kryer. Në rregulloren e institucionit dhe bazën ligjore të tij janë parashikuar kriteret dhe procedurat e diplomimit. Format i diplomës së programeve të akredituara të KPT është i miratuar përkatësisht nga QSHA. Për diplomat profesionale 2 vjeçare nuk parashikohet lëshimi i suplementit të diplomës. Studentët pajisen përkatësisht me numër matrikulli nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Pas përfundimit të studimeve, studenti ka të drejtë të kërkojë e të marrë një kopje zyrtare të silabuseve të programit të studimit të zhvilluar. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; Rregullorja e KPT, Evidenca 4; Miratimi i modelit të diplomës, Modeli i diplomës, Evidenca 40; VKM numër 699, datë 26/08/2015, Evidenca 1)</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	KPT ruan dokumentacionin e procesit mesimor dhe të dhënat e studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si p.sh. regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Regjistrat shpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar

	me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së KPT. Regjistrat plotësohen edhe në formë elektronike. KPT mbledh, ruan dhe përpunon të dhënat personale të studentëve në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë pa kufizim, Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar. Të dhënat personale të studentëve regjistrohen dhe ruhen në regjistrat përkatës dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të KPT. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit. <i>Referencë: DVV (RVB, dokumenti 5; Statuti i KPT, Evidenca 3; Regjistri bazë, themeltar, Evidenca 45; Regjistri i arritjeve akademike, Evidenca 45.1; Regjistri i diplomave, Evidenca 45.2)</i>			
Konkluzione	<i>Rregullorja e KPT dhe e programit të studimit kanë të specifikuar detyrimet përmbyllëse që ka studenti. Këto detyrime i komunikohen studentit paraprakisht nëpërmjet email-it. KPT ruan dokumentacionin e procesit mesimor dhe të dhënat e studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	Azhornimi me metodat e reja në mësimdhënie është në fokus të institucionit, sidomos pas zhvillimit të procesit të mësimdhënies gjatë dhe pas pandemisë Covid. Në fillim të çdo semestri bëhen të ditura programet e lëndëve, të cilat pasi miratohen dhe firmosen nga përgjegjësi i departamentit, zbatohen me rigorozitet nga lektorët përkatës. Nisur nga

fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	specifika e programit të studimit, kombinimi i pjesës teorike me praktikën zë një vend shumë të rëndësishëm në metodologjinë e mësimdhënies, duke kombinuar metodat moderne të TI me ato tradicionale. Pas shqyrtimit të DVV, vizitës në institucion dhe takimit me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se institucioni i mbështet metodat e ndryshme të mësimdhënies dhe harton udhëzues për përdorimin e tyre. <i>Referencë: DVV (RVB, Evidenca 25 Mesimi Online-Zyra IT Video Tutorial, Manual, Komunikime, Protokolli i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	GVJ konstatoi se KPT ka zhvilluar disa mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin periodik të personelit akademik, si më poshtë: Vlerësimi nga eprori, i cili kryhet në formën e kontrolleve në klasë dhe vlerësimin e silabusit; Vlerësimi nga studentët, i cili realizohet me anë të pyetësorëve anonimë në fund të çdo semestri, për çdo profesor/ lëndë, dhe fokusgrupet; Vlerësimi nga NJSBC, e cila ka për qëllim kordinimin e aktiviteteve të cilat lidhen me procesin mësimor dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies; <i>Referencë: DVV (RVB, Evidenca 13.2 Raporti NJSBC, Evidenca 15 Formularët e vlerësimit studente, Evidenca 16 Focus grupe)</i>
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Referuar DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si një njesi autonome në strukturën e institucionit, është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies. NJSBC përpilon raporte informuese për drejtuesit e departamenteve, me qëllim marrjen e masave për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>Referencë: DVV (RVB, Evidenca 3 Statuti, neni 16, Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC, Evidenca 13.2 Raporti NJSBC)</i>
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të	KPT inkurajon dhe nxit rritjen e vazhdueshme të personelit akademik duke ofruar trajnime për stafin (trajnime të brendshme ose në kuadër projektsh), duke nxitur kërkimin e aplikuar dhe duke promovuar shembuj të praktikave të mira nëpërmjet prezantimeve në Departament. <i>Referencë: DVV (RVB, Evidenca 19 Politika e kerkimit te aplikuar ne KPT, Evidenca 19.1 Kerkimi i aplikuar, Evidenca</i>

mësimdhënies.	6.2 Veprimtari te stafit ne kuader te projekteve, trajnimeve. Evidenca 49 Prezantimet ne departament)			
Konkluzione	Referuar kritereve të mësipërme, GVJ konstaton se KPT nxit sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie nëpërmjet inkurajimit të metodave të reja të mësimdhënies. Nisur nga specifika e programit të studimit, kombinimi i pjesës teorike me praktikën zë një vend shumë të rëndësishëm në metodologjinë e mësimdhënies, duke kombinuar metodat moderne te teknologjisë së informacionit me ato tradicionale. Njësia e Sigurimit të Bredshëm të Cilësisë (NJSBC), si një njesi autonome në strukturën e institucionit, është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies e cila përpilon raporte informuese për njësite bazë me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e	Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji Ndërtimi” ofrohet nga Kolegji Profesional i Tiranës, i cili në strukturën përbërëse të tij përfshin Departamentin e Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (njësia përgjegjëse për këtë program). Për vitin akademik 2023 – 2024: - 1 (një) Lektor me titullin Prof Dr. - 7 (shatë) Asistentë Lektorë me gradën MSc Për vitin akademik 2022- 2023:

programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	- 2 (dy) Lektor me titullin Prof Dr. PAE dhe - 8 (tetë) Asistentë Lektorë me gradën MSc. Për vitin akademik 2021- 2022: - 2 (dy) Lektor me titullin Prof Dr. - 8 (tetë) Asistentë Lektorë me gradën MSc. GVJ vlerëson se ky personel akademik përmbush kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me nivelin e kualifikimit akademik për drejtimin e këtij program studimi si dhe në angazhimin dhe mbulimin e lëndëve/moduleve të programit për fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike të këtij programi studimi. Stafi akademik i programit Për vitin akademik: 2021 – 2022 – 10 PAE /14 PAK Për vitin akademik: 2022 – 2023 – 10 PAE /13 PAK Për vitin akademik: 2023 -2024 8 PAE /6 PAK Ajo çfarë konstatohet nga GVJ është mungesa e personelit ndihmës akademik për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore. Gjatë vizitës në institucion si edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson përdorimin me efektivitet si të përvojës ashtu edhe burimeve e kapaciteteve. <i>Evidencë 6.1 Të dhënat e stafit ndër vite</i> <i>Evidencë 29 Manuali I Burimeve Njerëzore</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si edhe gjatë pyetjeve që GVJ bëri gjatë vizitës në Institucion, Departamenti përkatës shpërndan ngarkesën mësimore, sipas kualifikimit dhe përvojës së mësimdhënies së stafit të tij, në përputhje me kontratën individuale të punës dhe akteve rregullatore të KPT-së. Ngarkesa e stafit efektiv është përcaktuar me Vendim Rektorati. Por, përveç ngarkesës mësimore, stafi akademik efektiv angazhohet edhe në veprimtari të tjera ndihmëse dhe mbështetëse me natyrë akademike dhe institucionale (të cilat KPT i ka përcaktuar në kontratën individuale të punës). Sipas Vendimit të Rektoratit për vitin 2022-2023 norma vjetore e personelit akademik efektiv është 360 orë mësimore. <i>Evidencë 29.1 Dosja e Personelit</i> <i>Evidencë 29.3 Vendim rektorati për përcaktimin e ngarkesës mësimore</i> <i>Evidencë 29.9 Kontrata tip e punës</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë	Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur, GVJ vëren që personeli akademik i KPT përbëhet nga personel akademik,

qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	ndihmës mësimor dhe personel administrativ. Ky personel mund të jetë i punësuar me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Këto kontrata janë të lidhura sipas legjislacionit në fuqi, ku janë përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Mbështetur në evidencat e paraqitura, shikohet që personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë i qëndrueshëm gjatë periudhës së akreditimit. <i>Evidencë 3 Statuti, neni 37 (1)</i> <i>Evidencë 3 Statuti neni 37 (2)</i> <i>Evidencë 29.9 Kontrata tip e punës</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Për përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit “Teknologji Ndërtimi” në KPT është Departamenti (si njësi bazë) që nis procedurën për përcaktimin e kritereve të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe sipas nevojave të tij për staf. Personeli akademik zgjidhet me konkurs nga një komision rekrutimi, i cili ngrihet me Vendim Rektorati. Ajo që vërehet është se KPT mund të pranojë aplikime për personel akademik gjatë gjithë vitit. Aplikimet dorëzohen dorazi, ose me postë në zyrën e Burimeve Njerëzore. Intervistat bëhen në përputhje me ligjin si edhe sipas kritereve të vendosura. <i>Evidencë 3 Statuti, neni 39</i> <i>Evidencë 29 Manuali i Burimeve Njerëzore (proces rekrutimi)</i> <i>Evidencë 29.9 Kontrata tip e punës</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se personeli ndihmës akademik/laboratorik përzgjidhet me konkurs, pas shqyrtimit nga një Komision Rekrutimi të ngritur me Urdhër Rektori. Stafi ndihmës akademik mund të jetë efektiv ose me kontratë. Ajo çfarë konstatohet nga GJVJ është mungesa e personelit ndihmës akademik për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore. <i>Evidencë 3 Statuti, neni 39</i> <i>Evidencë 29 Manuali i Burimeve Njerëzore (proces rekrutimi)</i> <i>Evidencë 22 Labororet</i>

Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, në KPT është zyra e Burimeve Njerëzore përgjegjëse për mbledhjen dhe ruajtjen çdo vit të dosjeve të personelit akademik dhe administrativ. Nga vizita në Institucion pamë që në brendësi të dosjes ishin: Cv-të e stafit, dokumentat e identifikimit, diplomat dhe dokumentat e tjera të kualifikimit, raporti i aftësisë për punë, librezat e punës, lejet nga punëdhënësi etj. Të gjitha dokumentacionet ishin në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga përgjigjet që na u dhanë gjatë vizitës në Institucion mbi mungesën e stafit ndihmës akademik, na u sqarua se stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie përveç angazhimit në auditor kishte për detyrë të zhvillonte edhe tutoriat me studentët si edhe mbikqyrte studentët pranë subjekteve apo bizneseve gjatë zhvillimit të praktikave mësimore. <i>Evidencë 5 Rregullorja e Programit të studimit</i> <i>Evidencë 29 Manuali i Burimeve Njerëzore (Dosja e personelit)</i> <i>Evidencë 29.9 Kontrata tip e punës</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Nga vlerësimi i dokumentacionit, por edhe nga vizita që patëm në institucion, programi profesional i studimit “Teknologji Ndëtimi” ka marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, apo me biznese të ndryshme për të zhvilluar praktikat profesionale. Rezultoi se KPT ka nënshkruar marrëveshje të lidhura për këtë program studimi, si me kompaninë Gjeo-Vjosa Shpk, Alb Matrix Group Shpk, Alb-Building Shpk, Vagalat Shpk, Curri Shpk, etj., por edhe me IAL të tjera, si psh. Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës. KPT gjithashtu, ka marrëveshje bashkëpunimi me praktika.al. Për zbatimin e këtyre marrëveshjeve na u komunikua se KPT ka vënë në dispozicion stafin akademik për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale dhe veprimtari të tjera specifike për këtë program studimi në përputhje me rregulloren e praktikës profesionale. <i>Evidencë 33 Lista e partnerëve/marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidencë 5.1 Rregullorja e praktikës profesionale</i>
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të	Sipas marrëveshjeve me biznesin, subjekti pritës cakton një person ose personel mbikqyrës për çdo student që kryen praktikën. Na u komunikua që KPT mban pika kontakti me personin përgjegjës dhe në përfundim të praktikës, plotëson një formular vlerësimi për studentët praktikantë. Në përputhje

marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	me rregulloren e praktikës, por edhe sipas evidencave të paraqitura, studentët që ndjekin praktikën kanë një dosje të veçantë të plotësuar edhe me formularin e vlerësimit nga personi përgjegjës mbikqyrës në praktikën profesionale. <i>Evidencë 5.1 Rregullorja e praktikës profesionale</i>			
Konkluzione	<i>Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe nga vizita në institucion, GVJ vlerëson se programi i studimit me karakter profesional 2 vjeçar "Teknologji Ndërtimi" përmbush kryesisht standardin me personel që mbulon programin e studimit, Ajo çfarë konstatohet nga GVJ është mungesa e personelit ndihmës akademik për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita që patëm në Institucion, KPT ka siguruar mjedise bashkëkohore dhe komode për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Këto mjedise janë të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor (leksione/seminar/laboratore) sipas natyrës specifike të programit të studimit "Teknologji Ndërtimi". Hapësirat e auditoreve ishin të bollshme dhe të mjaftueshme për të garantuar një proces cilësor nga ana infrastrukturore. Institucioni ishte i pajisur me salla leksionesh, ambiente për zyra, salla konferencash, ashensor, shkalllë, mbrojtëse nga zjarri, rrufepritëse etj. GVJ vlerëson rëndësinë që institucioni u kishte dhënë infrastrukturës së laboratorëve. <i>Evidencë 34 Infrastruktura</i> <i>Evidencë 22 Labororet</i>
Kriteri 2. Mjediset	Nga vizita në godinën ku zhvillonte procesin mësimor

mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	programi i studimit “Teknologji Ndërtimi” pamë që mjediset mësimore ishin të ndara në klasa për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, si edhe laboratorë në funksion të procesit mësimor praktik. Klasat kishin hapësira të mjaftueshme për të zhvilluar mësim komod, si edhe ishin të pajisura me projektor dhe mjete të tjera teknologjike bashkëkohore. Gjithashtu, KPT kishte vënë në dispozicion ambjente për personelin akademik dhe administrativ, salla mbledhjesh, salla kompiuterash etj. Mjediset ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për të siguruar realizimin cilësor të procesit mësimor. Vlerësojmë pajisjen me internet wifi të gjitha ambjenteve, si edhe pajisjen e auditorëve me Smartboard, PC, projektorë etj. <i>Evidencë 34/1 Infrastruktura</i> <i>Evidencë 22 Laboratorët</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjatë vizitës që patëm në institucion patëm mundësinë të shikonim laboratorët si edhe mjediset e tjera në dispozicion të programit. Këto mjedise ishin të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme për zhvillimin cilësor të procesit mësimor duke plotësuar kërkesat e moduleve për aftësimin praktik dhe teorik të programit “Teknologji Ndërtimi”. Vlerësojmë pozitivisht infrastrukturën e laboratorëve përgjithësi të KPT, edhe pse për programin e studimit Teknologji Ndërtimi nuk kishte laborator specifik për teknologjinë e ndërtimit. - <i>Rekomandojmë hapjen e një laboratorit specifik për programin e studimit “Teknologji Ndërtimi”, të pajisur me aparatura për provat e fortësisë së betonit; për vetitë e hekurit etj., i cili do të ndikonte në rritjen e cilësisë së aftësimin praktik të studentëve të këtij programi.</i> <i>Evidencë 34/1 Infrastruktura</i> <i>Evidencë 22 Laboratorët</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjatë vizitës në institucion kishim mundësi të vizitonim një laborator të teknologjisë së informacionit, i cili ishte i pajisur me laptop dhe mjete të tjera teknologjike, për të përmbushur nevojat e programit të “Teknologjisë së Ndërtimit”. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, KPT kishte në total 4 laboratorë të teknologjisë së informacionit me 25 poste pune, 2 rack të lëvizshëm me 15 laptop secili dhe një pool prej 10 laptop-ësh. Vlerësojmë pozitivisht pajisjen me mjetet bashkëkohore të

	teknologjisë së informacionit, për të siguruar një proces mësimor cilësor dhe bashkëkohorë. <i>Evidencë 34/1 Infrastruktura</i> <i>Evidencë 22 Laboratorët</i>			
Konkluzione	- <i>Institucioni i arsimit të lartë ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Teknologji Ndërtimi, si për formimin praktik ashtu edhe teorik. Por Rekomandojmë hapjen e një laboratorit specifik për programin e studimit "Teknologji Ndërtimi", të pajisur me aparaturë për provat e fortësisë së betonit; për vetitë e hekurit etj., i cili do të ndikonte në rritjen e cilësisë së aftësisë praktik të studentëve të këtij programi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit "Teknologji Ndërtimi", pamë që modulet/lëndët ishin të pajisura me literature bazë dhe ndihmëse të përditësuar, për të garantuar marrjen e dijeve dhe njohurive përkatëse. Literatura është e pasqyruar në syllabuset e lëndëve. Në syllabus shënohet literatura bazë (ose e detyrueshme), si edhe literatura ndihmëse. Na u komunikua që pedagogu i lëndës jepte sqarimet përkatëse ku gjendet kjo literaturë dhe si mund të aksesohet nga studenti. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, shkuam në bibliotekën e KPT, e cila ishte e përbashkët me bibliotekën e UET. Organizimi dhe funksionimi i bibliotekës ishte rregulluar me Rregulloren e Bibliotekës, sipas evidences së paratur, së bashku me oraret që ishin të afishuara në mënyrë të dukshme. Literatura digjitale jepej përmes "Open Educational

	Resources OER”, e cila ishte një librari online e pajisur me literaturë për modulet e lëndëve. Ambjentet e bibliotekës e mundësonin aksesin online. <i>Evidencë 34/1 Infrastruktura</i> <i>Evidencë 34/2 Biblioteka, rregullorja</i> <i>Evidencë 34/3 karta e bibliotekës</i> <i>Evidencë 3 Statuti</i> <i>Evidencë 5.5 Model Syllabusi</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve Bibliotekën (fizike), e cila ndodhej në katin e parë të godinës dhe ishte lehtësisht e aksesueshme; por edhe bibliotekën digjitale, ku studentët mund të aksesohen online. Vlerësojmë përpjekjet e institucionit për të garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë të ambjenteve, por edhe lehtësinë për tu aksesuar online me qëllim shfrytëzimin e literaturës bazë dhe ndihmëse. <i>Evidencë 34/2 Biblioteka, rregullorja</i> <i>Evidencë 34/3 karta e bibliotekës</i> <i>Evidencë 34/4 Biblioteka online</i>
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në Institucion, na u garantua që biblioteka është e pasur me materiale dhe libra mësimor, tekste shqip dhe gjuhë të huaj, për të marrjen e njohurive sipas lëndëve dhe moduleve të këtij programi studimi. Biblioteka ishte e pajisur gjithashtu edhe me revista shkencore të nevojshme dhe mendojmë të mjaftueshme për mbulimin e të gjitha moduleve të programit Teknologji Ndërtimi. Pedagogët depozitonin në bibliotekë edhe leksionet, apo materialet mësimore të nevojshme për lëndët e këtij programi studimi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, nuk kemi një numër të saktë për fondin e teksteve në dispozicion të moduleve që mbulon ky program studimi <i>Evidencë 34/2 Biblioteka, rregullorja</i> <i>Evidencë 34/4 Biblioteka online</i>
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës që patëm në ambjentet e KPT, pamë që institucioni kishte vendosur internet wifi në ambjentet e bibliotekës dhe jo vetëm, për të siguruar kushte të barabarta të shfrytëzimit pa pagesë të teksteve online të vëna në dispozicion të këtij programi studimi. Studentët mund të aksesonin në https://kolegjiiprofesional.edu.al/online-library-oer për të lexuar dhe punuar me materialet kërkimore shkencore, tekstet e vëna në dispozicion sipas syllabuseve të lëndëve.

	Gjithashtu studentët, përveç materialeve të printuara në kopje fizike, mund të shfrytëzonin edhe platformat online si <i>Sharefolder</i>, e cila aksesohet nga PC të lidhura me rrjetin e KPT. <i>Evidencë 34/2 Biblioteka, rregullorja</i> <i>Evidencë 34/4 Biblioteka online</i>
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	Sipas rregullores në evidencat e paraqitura, biblioteka ofron kushtet logjistike dhe ergonomike për një përdorim efikas të ambienteve të vëna në dispozicion. Ambjentet janë të pajisura me PC me qasje në internet dhe mund të shfrytëzohen nga studentët, sipas orareve të paraqitura në rregullore. Biblioteka dhe koleksionet online mund të përdoren edhe nga studentët edhe nga pedagogët. Platformat online si <i>Sharefolder</i> aksesohet nga PC të lidhura me rrjetin e KPT. <i>Evidencë 34/2 Biblioteka, rregullorja</i> <i>Evidencë 34/3 karta e bibliotekës</i> <i>Evidencë 34/4 Biblioteka online</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga ambjentet e bibliotekës që vizituar në institucion, pamë që ishin të afishuara orari i bibliotekës, i përshtatur me oraret sipas programeve të studimit, përkatësisht: e hënë – e premte ora 09.00 – 20.00 dhe e shtunë ora 09.00 – 17.00. Vlerësojmë faktin që gjatë sezonit të provimeve, orari i bibliotekës ishte më fleksibël dhe i zgjat, për të mundësuar shërbim sipas nevojave dhe numrit të studentëve. <i>Evidencë 34/2 Biblioteka, rregullorja</i> <i>Evidencë 34/4 Biblioteka online</i>
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ pa që syllauset kishin të pasqyruar literaturën përkatëse (të detyrueshme dhe ndihmëse) e cila ishte bashkëkohore dhe e përditësuar me kërkesat e tregut. Njësia përgjegjëse për ndjekjen dhe raportimin e literaturës është Departamenti. Programi i studimit “Teknologji Ndërtimi” nuk ka një raport për shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e tij. Studentët janë të lirë të shfrytëzojnë sallat e studimit, por nuk janë evidentuar dhe nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj etj. - Rekomandojmë që biblioteka, ose njësia përgjegjëse e programit, të ndjekë dhe të raportojë cilësinë e fondit fizik

sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	dhe online si edhe shkallën e përdorimit të tij nga studentët dhe stafi akademik, me qëllim rritjen e cilësisë së literaturës dhe aksesueshmërisë së saj. Evidencë 34/2 Biblioteka, rregullorja Evidencë 34/4 Biblioteka online			
Konkluzione	- GVJ shpreh përmbushjen e standardit kryesisht. IAL ka literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies, mjediset mbështetëse të mësimnxënies Rekomandojmë që biblioteka, ose njësia përgjegjëse e programit, të ndjekë dhe të raportojë cilësinë e fondit fizik dhe online si edhe shkallën e përdorimit të tij nga studentët dhe stafi akademik, me qëllim rritjen e cilësisë së literaturës dhe aksesueshmërisë së saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	Nga dokumentacioni i paraqitur, por edhe nga pyetje-përgjigjet gjatë vizitës në Institucion, na u komunikua se KPT disponon një sistem menaxhimi të informatizuar, që përshin anën administrative dhe anën akademike. Përkatësisht, Zyrën e Burimeve Njerëzore, Sekretarinë Mësimore etj., si edhe stafin akademik dhe studentët. Përdorimi i këtij sistemi informatik është i kompletuar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike, sipas akteve ligjore në fuqi. Aplikacionet në nivel institucional janë të vendosura në sistemin <i>Classter</i>, i cili përshin gjithë modulet e sistemit të menaxhimit të informacionit të studentëve. Në këtë App menaxhohet informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre (orari i mësimit, rezultatet e provimit etj.) Sistemi është i mundësuar në bazë të kontratës me shoqërinë <i>Tech360 sh.p.k.</i> Evidencë 28/1 Sistemi <i>Classter</i>			
Kriteri 2. Sistemi i	KPT është e pajisur me një sistem të brendshëm menaxhimi,			

brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	me të cilin administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ky informacion përpunohet dhe administrohet nga personeli përgjegjës i burimeve njerëzore dhe sekretaria mësimore (të përcaktuara me rregullore, sipas evidencave). Gjatë vizitës në institucion pamë që dosjet fizike të personelit mbaheshin në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe administroheshin prej saj. <i>Evidencë 28/1 Sistemi Classter</i> <i>Evidencë 29/1 Dosja e personelit</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Siç na u komunikua gjatë vizitës në KPT, i gjithë sistemi informatik ka qasje të bazuar në përdorues/ fjalëkalime në zbatim të procedurave të sigurisë së informacionit ISO27001. Kjo përfshin: sistemin e ndërtuar dhe mirëmbajtur nga institucioni, platformat komerciale <i>Microsoft</i> të përdorura nga KPT etj. Aksesit ishte i ndarë në: - <i>Share Folder</i> (nivel lokal), i cili përdorej për të shkëmbyer materiale në rang administrate, stafi, pedagog-student etj. - <i>Share Point</i> (One Drive), pjesë e <i>Office365</i>, ku mund të aksesohet brenda institucionit ose jo. Integrimi i platformave të tjera si <i>Forms</i>, <i>Teams</i>, <i>Stream</i> etj - Sistemi <i>Classter</i>, ku pedagogët mund t'u mundësojnë studentëve materiale si literaturë, syllabuse, ushtrime etj. Kjo formë sistemi menaxhimi siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin akademik, administrativ dhe studentët e çdo programi studimi në këtë institucion. <i>Evidencë 28/1 Sistemi Classter</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nga dokumentacioni i paraqitur, por edhe nga komunikimet gjatë vizitës në institucion, na u tregua <i>Sistemi Classter</i>, i cili mundëson menaxhimin dhe komunikimin interaktiv për shkëmbimin e informacionit nëpërmjet studentëve dhe stafit akademik. Kjo përfshin: sistemin e ndërtuar dhe mirëmbajtur nga institucioni, platformat komerciale <i>Microsoft</i> të përdorura nga KPT etj. Aksesit ishte i ndarë në: <i>Share Folder</i> (nivel lokal), i cili përdorej për të shkëmbyer materiale në rang administrate, stafi, pedagog-student etj.; <i>Share Point</i> (One Drive), pjesë e <i>Office365</i>, ku mund të aksesohet brenda institucionit ose jo. Integrimi i platformave të tjera si <i>Forms</i>, <i>Teams</i>, <i>Stream</i> etj.; Sistemi <i>Classter</i>, ku pedagogët mund t'u

	mundësojnë studentëve materiale si literaturë, syllabuse, ushtrime etj. Këto sisteme menaxhimi mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. <i>Evidencë 28/1 Sistemi Classter</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit që përdor KPT për programin e studimit Teknologji Ndërtimi është <i>Classter</i>. Ky system informatik është i realizuar nëpërmjet kontratës me subjektin Tech360 sh.p.k. për menaxhimin e aktivitetit akademik dhe administrativ, në funksion të studentëve dhe organeve drejtuese. Na u komunikua që ky system ishte efikas, duke garantuar dhe monitoruar në kohë reale aktivitetin akademik dhe atë administrativ. <i>Evidencë 28/1 Sistemi Classter</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Kolegji Profesional i Tiranës ka ndërtuar një faqe online, në të cilën publikohen informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme etj. Faqja: https://kolegjiprofesional.edu.al/ Faqja zyrtare azhurnohet në mënyrë të vazhdueshme nga personat përgjegjës (IT), për publikimin e informacioneve të nevojshme për stafin akademik, studentët dhe palët e treta. <i>Evidencë 35 Politika e mirëmbajtjes së faqes së Internetit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet e KPT për azhurnimin dhe administrimin e një sistemi të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga dokumentacioni i paraqitur, KPT është institucion i arsimit të lartë privat me vetëfinancim. Siç na u pohua, burimet financiare përfshinin tarifat e shkollimit, projekte/grante ndërkombëtare të KPT, financim nga ortakët e institucionit, të ardhura nga shërbimet për palët e treta etj. Nga verifikimi i faqes online të KPT-së, ishin të publikuara tarifat, ndërsa veprimtaritë në lidhje me kontabilitetin mbahen në një program financiar të quajtur <i>Alpha</i>. Pasqyrat financiare miratohen nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve dhe depozitoheshin elektronikisht në zyrën e tatimeve. Duke qenë se KPT është një IAL me vetëfinancim, shqyrton dhe analizon çdo vit koston e secilit program studimit. Buxheti financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe ngarkohet Administratori dhe Zyra e finances për zbatim. Gjatë vizitës na u pohua vështirësia financiare për mbajtjen hapur të programit të studimit “Teknologji Ndërtimi”, për shkak të mungesës së studentëve të regjistruar. Sipas Tabelës 18 të Finances në evidencat e paraqitura, të ardhurat gjatë 3 viteve të fundit vijnë rreth 80% nga tarifat për dhe gjatë shkollimit. <i>Evidencë 7 Strategjia 2021 – 2025</i> <i>Evidencë Financa tabela 18</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të	Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk kemi materiale mbi një plan të financimit të Njesisë Bazë përgjegjëse për programin e studimit “Teknologji Ndërtimi”. Në Evidenca paraqitet vetëm Tabela 18 Financa, e cila përmban burimin e të ardhurave të KPT gjatë viteve 2021, 2022, 2023. <i>Rekomandojmë të bëhet një plan për financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë në rang programi studimi</i> <i>Evidencë Financa tabela 18</i> <i>Evidencë 36 Raporti Vjetor</i>

studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, funksionet administrative dhe ekonomiko - financiare realizohen nëpërmjet Zyrës së Financës dhe Administratorit, e më pas me ortakët e KPT. Raportimet financiare mbahen në programin <i>Alpha</i>. Në dokumentacionin e paraqitur nuk është raportuar të jenë kryer auditime periodike për vlerësimin e gjendjes së financimit dhe efektivitetit financiar për këtë program studimi dhe e KPT në tërësi. GVJ konstaton që numri i regjistrimeve të studentëve në këtë program studimi është 0 (zero). Duke qenëse të ardhurat vijnë 80% nga regjistrimi i studentëve, Institucioni duhet të kryej auditim periodik, për të vlerësuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij si edhe vlerësimin ekonomik të këtij programi studimi. - Studentë të regjistruar në vitin 2021-2022 – 0 (zero) studentë - Studentë të regjistruar në vitin 2022-2023 – 7 (shtatë) studentë - Studentë të regjistruar në vitin 2023-2024 – 0 (zero) studentë - Studentë të regjistruar në vitin 2024-2025 – 0 (zero) studentë <i>Evidencë Financa tabela 18</i> <i>Evidencë 36 Raporti Vjetor</i> <i>Evidencë 6 Të dhënat e studentëve ndër vite</i>
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Raportet nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për shkak të natyrës jo publike të arsimit të lartë. Institucioni nuk ka raportuar deri në nivelin e Njësisë Bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. <i>Evidencë Financa tabela 18</i> <i>Evidencë 36 Raporti Vjetor</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të	Institucioni duhet të garantojë qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit “Teknologji Ndërtimi” dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të tij. Duke qenë se KPT është IAL privat me

njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	vetëfinancim, burimet financiare vijnë nga tarifat e shkollimit, projekte/grante ndërkombëtare, financim të ortakëve në cilësinë e pronarit si edhe të ardhurave nga të tretët. Sipas Evidencës nga Financa Tabela 18, të ardhurat në nivel 80% për tre vitet e fundit vijnë nga tarifa për dhe gjatë studimit. Gjithashtu, sipas evidences 36 Raporti Vjetor, shihet që programi i studimit “Teknologji Ndërtimi” ka një tarifë 2200 euro/vit. Nga vizita në institucion na u pohua se ky program studimi nuk ka regjistrime studentësh për këtë vit akademik. Duke qenëse nuk kemi një raport financiar dhe asnjë dokument që vërteton qëndrueshmërinë financiare të institucionit, nuk mund të vlerësojmë qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e këtij programi studimi. <i>Evidencë Financa tabela 18</i> <i>Evidencë 36 Raporti Vjetor</i> <i>Evidencë 6 Të dhënat e studentëve ndër vite</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ të KPT, por nuk mund të shprehemi për qëndrueshmërinë financiare të tij në lidhje me këtë program studimi, për shkak të mungesës së regjistrimeve të studentëve. Kjo sepse 80% e të ardhurave vijnë nga regjistrimi i studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton	Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, procesi nga

dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	pranimi deri në diplomimin e studentëve është i rregulluar sipas legjislacionit në fuqi si edhe statutit dhe rregulloreve përkatëse të Kolegjit Profesional të Tiranës. Për sa i përket kritereve dhe procedurën e aplikimit, këto publikohen online në faqen e KPT, si edhe me broshura informuese, reklamave etj. Informacioni publikohet në format fizik (në formën e guidave, rregulloreve, manualeve etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve; në format fizik të shpalluar dhe publikuara në mjediset e KPT, si orari i mësimi, njoftime të ndryshme zyrtare etj.; si edhe në format elektronik në faqen zyrtare online dhe aplikacionit <i>Casster</i>. Na u pohua që Vendimet e Senatit, Rektoratit si edhe të Departamentit u bëhen me dije studentëve në forma të ndryshme, si për shembull takime të drejtpërdrejta, shpallje në mjediset e institucionit etj. <i>Evidencë 4 Rregullorja e KPT</i> <i>Evidencë 5 Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidencë 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit</i> <i>Evidencë 6.6 Raporti i cilësisë së studentëve</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita që patëm në institucion, na u pohua që KPT garanton barazinë dhe të drejtat e njëjta për të gjithë kandidatët për student. Për këtë gjë institucioni ka hartuar akte rregullatore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Duke qenëse ky program studimi ka karakter profesional, kandidatët për pranimin për student nuk kanë kusht dhe kriter mesataren. Dokumentat e kërkuara për regjistrim janë në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi. <i>Evidencë 4 Rregullorja e KPT</i> <i>Evidenca 23 Vendimet e Senatit Akademik</i> <i>Evidencë 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, KPT për çdo vit akademik përcakton me vendim Senati kriteret për pranimin e studentëve. Sipas akteve ligjore në fuqi, KPT dorëzon kriteret e pranimi të studentëve pranë Ministrisë së Arsimit, si edhe numrin e kuotave për program. Për t'u regjistruar në programin e studimit "Teknologji Ndërtimi" duhen: - Fotokopje e noterizuar e Diplomës së Maturës Shtetërore, së bashku me certifikatën e notave, ose dëftësë/diploma tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehësuar nga MAS; - Certifikatë familjare; - Dokument identifikimi (fotokopje e ID kartë; pasaportë) - Si edhe çdo document tjetër të përcaktuar sipas nevojave

	të KPT. <i>Evidencë 4 Rregullorja e KPT</i> <i>Evidenca 23 Vendimet e Senatit Akademik</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme online në faqen e KPT. Për studentët e rinj të regjistruar realizohet <i>Java e Orientimit</i>, ku bëhen sqarime mbi rregulloren, mnyrën e zhvillimit të mësimi dhe çdo paqartësi tjetër. Gjatë kësaj jave studentët njihen me ambientet e institucionit, labororet dhe sallat ku do zhvillohet mësimi. Në fillim të çdo viti akademik studentëve u vihet në dispozicion programet e lëndëve (syllabusi). Sipas dokumentacionit të paraqitur në evidenca, informimi dhe ndërgjegjësimi për t'u regjistruar në KPT realizohet në përputhje me "<i>Politikën e procedurat e komunikimit në KPT</i>" nëpërmjet organizimit të takimeve informuese dhe sqaruese me nxënësit e shkollave të mesme dhe përfaqësues të KPT; organizimit të tryezave të përbashkëta dhe veprimtrive me karakter mësimor-informues-argëtues me nxënësit e shkollave të mesme në mjediset e Kolegjit; përgatitje dhe shpërndarje e materialeve informuese, broshurave etj.; dalje publike në media etj. <i>Evidencë 30 Java e Orientimit</i> <i>Evidenca 5.5 Syllabuset</i>
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Nga shqyrtimi i evidencave, sipas statutit KPT synon të ofrojë shërbimet e tij në formë cilësore dhe efikase qoftë për arsimim ashtu edhe për pale të treta. KPT ka të hartuar Rregulloren për Studentët me Aftësi Ndryshe dhe ka bërë përpjekje pozitive për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për këtë kategori studentësh. GVJ vlerëson infrastrukturën lehtësuese në lidhje me personat me aftësi ndryshe, si për shembull hyrjen në nivel toke; tualete për persona me aftësi ndryshe etj. <i>Evidencë 3 Statuti</i>
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për	Nga vizita në Institucion gjatë takimeve me stafin na u pohua se një nga prioritetet e Kolegjit Profesional të Tiranës është vlerësimi i punës dhe meritat e çdo studenti nëpërmjet ofrimit të bursave në varësi të mesatares. Gjithashtu, KPT ka ndarë informacione të ndryshme në lidhje me mundësitë për bursa apo financime për studentët (si për

zhvillimin ekonomik të vendit.	shembull Bootvamp i sipërmarrjes, Connect IT projekti I GIZ dhe BE etj.) <i>Evidencë 39 Connect IT etj.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shpreh vlerësim pozitiv mbi Kolegjin Profesional të Tiranës për hartimin, ndjekien dhe zbatimin e politikave dhe procedurave për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, komunikimi brenda dhe jashtë institucionit bëhet në bazë të <i>Politikës së Komunikimit</i>, si edhe të <i>Politikës së Përdorimit të Internetit</i>, <i>Postës Elektronike</i> dhe <i>Infrastrukturës</i>. Në KPT funksionon Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit, e cila në kuadër të politikave të pranimit jep informacion për KPT dhe programet e saj të studimit, si edhe orienton të interesuarit. Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Sekretaria Mësimore dhe Koordinatorët, luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve dhe punën e stafit akademik. Nga takimi në institucion, u informuam se komunikimi në KPT është verbal dhe shkresor, por edhe nëpërmjet mejteve online të komunikimit. Gjithashtu KPT disponon një database të saktë me të dhënat e studentëve, e cila përfshin adresën e banimit, adresën e postës elektronike, numrin e telefonit etj. Në qendër të këtij komunikimi është sistemi Classter, por edhe faqa zyrtare online e KPT. Numri i studenteve 2022-2023 7 2023-2024 nuk ka regjistrime <i>Evidencë 24 Politika e Komunikimit</i> <i>Evidencë 37 Politika e Internetit</i> <i>Evidencë 3 Statuti</i>

	<i>Evidencë 17 Tutoriatet këshillim akademik</i> <i>Evidencë 25 Mësimi online</i> <i>Evidencë 37.2 Politika e menaxhimit të faqes së internetit</i> <i>Evidencë 27 Manuali I studentit</i> <i>Evidencë 24 Open days KPT</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, Kolegji Profesional i Tiranës informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme nëpërmjet: - Këshillimit me stafin akademik; - Kontaktet me Zyrën e Informacionit të Studentit - Rregullores së KPT-së dhe programit të studimit TN <i>Evidencë 24 Politika e Komunikimit</i> <i>Evidencë 37 Politika e Internetit</i> <i>Evidencë 3 Statuti</i> <i>Evidencë 27 Manuali i studentit</i> <i>Evidencë 24 Open days KPT, panaiet</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit me karakter profesional “Teknologji Ndërtimi” jepen në Rregulloren e KPT, si edhe në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve. Vlerësimi shprehet në note dhe germë, përcaktuar sipas rregullores së programit të studimit dhe rregullores së KPT. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rregullorja ka të përcaktuar qartë mënyrën e kontrollit të dijeve, modalitetet rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes, për provimet dhe riprovimet që stafi akademik dhe studentët duhet të ndjekin në çdo rast. <i>Evidencë 4 Rregullorja e KPT</i> <i>Evidencë 5 Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidencë 5.5 Syllabuset</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar nga GVJ, KPT ka të hartuar rregulloren e saj si edhe rregulloren e programit të studimit. Në këto rregullore janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit. Përkatësisht: Rregullorja e KPT, Kreu V, ka të përcaktuar dhe sqaruar mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes dhe veçanërisht të provimeve dhe riprovimeve. Janë përfshirë procedurat që duhen ndjekur, rregullat e hartimit të tezave, monitorimi dhe sekretimi i provimeve, të drejtat dhe detyrimet e studentit etj. Gjithashtu, është përcaktuar edhe mënyra e vlerësimit. Në nenin 56,

	Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar i studentit. Mbrojtja bëhet ose me provim formimi, ose me temë sipas Vendimit të Rektoratit. Na u komunikua që studentët vihen në dijeni për rregulloren dhe mënyrën e zhvillimit të provimeve. Format i diplomë është i miratuar nga QSHA. - <i>Rekomandojmë që për programin e studimit me karakter profesional "Teknologji Ndërtimi", duhet të përgatiten edhe suplementet e diplomave, ku të jetë reflektuar kurikula e këtij programi studimi.</i> <i>Evidencë 4 Rregullorja e KPT</i> <i>Evidencë 5 Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidencë 5.5 Syllabuset</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Nga takimi që patëm në ambjentet e KPT, na u komunikua që ky institucion ndjek politika të komunikimit, sipas rregulloreve të miratuar. Bazuar në evidencën e Statutit të paraqitur në dosje, por edhe sipas rregulloreve të KPT, detyrat funksionale dhe Politika e Komunikimit, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave si edhe ajo e Karrierës, Mbështetje së Informimit dhe Sekretaria Mësimore luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e informimit dhe pranimit të studentëve të rinj. Na u komunikua që KPT organizon dhe ndërmer aktivitetet dhe evente të ndryshme në përputhje me udhëzimet e strukturave përgjegjëse për arsimim, në bashkëpunim me ZVA dhe DPAP. Gjithashtu, kryhen vizita nga maturantët, mësuesit etj., në ambjentet e këtij institucioni për të parë dhe njohur nga afër me infrastrukturën, stafin etj. Sipas evidencave të paraqitura, institucioni është rregullisht pjesëmarrës në panairët e organizuara nga Dhoma e Tregëtisë, apo panairë të tjera, si edhe në organizimin e eventeve apo konkurseve me pjesëmarrje të gjimnazistëve. GVJ vlerëson institucionin për pajisjen e studentëve me <i>Kartën e Studentit</i>, të cilën e ka realizuar në bazë të marrëveshjes me Bashkinë e Tiranës, ku studentët e saj kanë të drejtë të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara ose falas. <i>Evidencë 24 Politika e komunikimit</i> <i>Evidencë 24/2 Open Days</i> <i>Evidencë 6.5 NASA Hackathon, konkurs</i> <i>Evidencë 30 Java e orientimit</i> <i>Evidencë 25 Mësimi online</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet e institucionit për vënien në dispozicion të studentëve të programit të studimit</i>

	<i>"Teknologji Ndëtimi" informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nga vlerësimi i evidencave të paraqitura, Kolegji Profesional i Tiranës ka ndërtuar një faqe zyrtare, në të cilën përditësohen në mënyrë periodike të gjitha informacionet lidhur me këtë institucion, përkatësisht: programet e studimit, struktura e KPT, organizimi i saj, ofertat akademike etj. Informacionet e publikuata përditësohen në përputhje me Politikën e Menaxhimit të faqes së Internetit. Faqja zyrtare e KPT është: https://kolegjiiprofesional.edu.al/ Në këtë faqe gjenden struktura, organizimi dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Studentët kanë mundësi të aksesohen me wifi në ambjentet e KPT. <i>Evidencë 30/1 Politika e Menaxhimit të Faqes së Internetit</i> <i>Evidencë 23 Vendimet e Senatit</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion u njohëm me "Manualin e Studentit" dhe systemin Classter, nëpërmjet të cilëve institucioni kishte vënë. Në dispozicion të studentëve informacione dhe dokumentacione apo udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, e programit të studimit "Teknologji Ndëtimi" Gjithashtu, edhe në faqen zyrtare https://kolegjiiprofesional.edu.al/ gjenden informacione të detajuara në lidhje me strukturën dhe organizimin e KPT, programet e studimit, personelin akademik, shërbimet, ofertën akademike, aktet rregullatore të institucionit, Statutin etj. Përveç faqes zyrtare të internetit, KPT përdor si mjet informues edhe rrjetet sociale. <i>Evidencë 30/1 Politika e Menaxhimit të Faqes së Internetit</i> <i>Evidencë 23 Vendimet e Senatit</i>

	<i>Evidencë 28/1 Sistemi i institucionit Classter</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga vizita që patëm në institucion dhe komunikimi me studentin e programit “Teknologji Ndërtimi”, na u pohua se institucioni kishte ndihmuar në mundësinë për t’u njohur me tregun e punës dhe mundësinë për të gjetur punë. Në institucion funksionon Zyra e Karrierës Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, e cila mban një database me të dhënat e çdo studenti të diplomuar në lidhje me punësimin dhe karrierën e tij. Gjithashtu, kjo zyrë mbante komunikime dhe kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, këshillimin për studentët e papunësuar si edhe për t’i asistuar në hyrjen dhe përshtatjen me tregun e punës. Na u pohua gjithashtu se KPT ishte në kontakt të vazhdueshëm me biznese apo industri të ndryshme në lidhje me mundësinë e punësimit të studentëve të diplomuar. Mundësia për njohjen me tregun e punës bëhej nëpërmjet Praktikave Profesionale, por edhe nëpërmjet organizimit të takimeve të hapura me biznese, industri, apo organizata të ndryshme. Në këto takime studentëve u jepej mundësi për promovimin e tyre dhe rritjen e mundësisë së punësimit brenda apo jashtë vendit. Rol të rëndësishëm luajnë marrëveshjet që ky institucion ka me Bashkinë e Tiranës, por edhe mobilitetet pranë kompanive të huaja në vendet e BE-së falë projekteve ndërkombëtare ku KPT është pjesë. <i>Evidencë 12 Sondazhi Alumni</i> <i>Evidencë 33 Lista e Partnerëve dhe marrëveshjeve</i> <i>Evidencë 44 Thirrje/njoftime punësimi</i> <i>Evidencë 31 Takime me biznese</i> <i>Evidencë 21 Trajnime studentësh</i> <i>Evidencë 38 Praktika Connected through Mobility</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga takimi që patëm në institucion me stafin akademik, studentin dhe stafin administrativ na u komunikua që KPT vinte në dispozicion kriteret dhe procedurat në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nëpërmjet: këshillimit me stafin akademik; Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit; rregullores së KPT/ rregullores mësimore; kontratës që nënshkruhet nga KPT në momentin e regjistrimit; Javës së orientimit etj. Gjithashtu, koordinatoja e Departamentit mbante kontakte të rregullta elektronike dhe me telefon me studentët që ndjekin këtë program studimi për azhurnimin e tyre mbi infrastrukturën, aktivitetet e ndryshme, informacione që lidhen me oraret etj. Çdo informacion tjetër

	në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik apo aktivitete të tjera mësimore të organizuara nga institucioni u dërgohen studentëve nëpërmjet postës elektronike dhe sistemit Classter, por edhe nëpërmjet publikimeve në faqen zyrtare të KPT. <i>Evidencë 30/1 Politika e Menaxhimit të Faqes së Internetit</i> <i>Evidencë 23 Vendimet e Senatit</i> <i>Evidencë 28/1 Sistemi i institucionit Classter</i>			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Nga komunikimet që patëm me stafin drejtues të KPT, si edhe nga evidencat e paraqitura vlerësojmë bashkëpunimin e këtij institucioni me biznesin dhe industrinë, por edhe me institucione të tjera shtetërore apo IAL për të realizuar praktikat profesionale. Institucioni informon studentët nëpërmjet komunikimeve të staf – student por edhe nëpërmjet rrugëve të tjera zyrtare, për çdo bashkëpunim me biznesin me qëllim zhvillimin e praktikave profesionale, mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. <i>Evidencë 30/1 Politika e Menaxhimit të Faqes së Internetit</i> <i>Evidencë 28/1 Sistemi i institucionit Classter</i> <i>Evidencë 33 Lista e partnerëve Marrëveshjeve me subjektet pritëse për praktikat</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson pozitivisht Kolegjin Profesional të Tiranës për vënien në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit elektronik, fizik dhe platformave të ndryshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore	Nga dokumentacioni i paraqitur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, por edhe nga takimi që patëm me stafin e KPT,

për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	institucioni dispononte statistika të plota për studentët e tij. Këto përfshijnë: regjistrimet, transferimet, çrregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje, shkallën e punësimit etj. Sipas evidences së Statutit të KPT, Zyra e Protokoll Arkivës, Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria Mësimore, Zyra e dokumentacionit, Zyra e Financës, Zyra e IT dhe Projekteve përgjigjen për ruajtjen e dokumentacionit dhe për të gjitha veprimatritë e rëndësishme të institucionit. Dokumentacioni mbahej dhe ruhej në mënyrë elektronike dhe në format hard copy nga Zyra e Dokumentacionit dhe Zyra e IT përmes sistemit Classter. Koordinatorja e Departamentit mbledh, përpunon dhe administron dokumentacionin e punës për këtë program studimi, si për shembull: punët e Laboratorit, syllabuset e lëndëve, procesverbalet e mbledhjeve, regjistrat e lëndëve, provimet, procesverbalet e notave etj. Zyra e Protokollit dhe Arkivës në bashkëpunime me Sekretarinë mësimore dhe Zyrën e Financës është përgjegjëse për nxjerrjen e statistikave, raporteve vjetore, sipas nevojave të institucionit. Kolegji dispononte të dhëna mbi ecurinë akademike të të gjithë studentëve të saj. <i>Evidencë 3 Statuti I KPT</i> <i>Evidencë 28/1 Sistemi i institucionit Classter</i> <i>Evidencë 45 Regjistri bazë</i>
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sipas evidencave të paraqitura, por edhe nga vizita që patëm në insitucion shikuam që të dhënat e studentëve menaxhoheshin në sistemin Classter. Ndërsa Zyra e Fiancës përdor sisteme të veçanta që lidhen me kontabilitetin (sistemi Alpha), në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të garantuar sigurinë e informacionit, aksesin dhe nivelet e tij, realizoheshin me <i>emër përdoruesi</i> dhe <i>fjalëkalim</i> të personalizuar, duke mundësuar evidentimin e çdo hyrje <i>log-in</i> në sistem. Të dhënat mbaheshin të regjistruara në regjistra fizik dhe administroheshin nga zyrat përkatëse (sipas evidences së Statutit) dhe firmosen nga personat përgjegjës <i>Evidencë 3 Statuti I KPT</i> <i>Evidencë 28/1 Sistemi i institucionit Classter</i> <i>Evidencë 45 Regjistri bazë</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për	Vlerësojmë institucionin për mbështetjen e veprimtarisë së saj me aktet përkatëse, në kontrollin e vazhdueshëm dhe menaxhimin nga të gjitha njësitë mësimore dhe administrative, në dokumentacionin dhe evidencat përkatëse

menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	që lidhen me procesin mësimor dhe veprimtarinë e studentëve në tërësi. Vërtetohet që dokumentacioni ruhet në format fizik dhe elektronik, sipas rregullores së KPT. Na u komunikua gjithashtu se KPT përfshinte edhe ekspertë të jashtëm për vlerësimin e aspekteve të ndryshme të aktivitetit të tij, si për shembull të rishikimit dhe përmirësimit të kurrikulave të programeve të studimit etj. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhoheshin përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe ishin të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. <i>Evidencë 3 Statuti I KPT</i> <i>Evidencë 45 Regjistri bazë</i>			
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nga dokumentat e vlerësuara, Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional “Teknologji Ndërtimi”. Kjo njësi, në bashkëpunim me Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë NJBSC dhe Sekretarinë Mësimore vlerësojnë cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve për këtë program studimi. Edhe pse Departamenti nuk ka një raport periodik analitik, feedback-u i vlerësimit të studentëve gjatë praktikës profesionale, apo mobiliteteve në vendet e BE-së si edhe punësimi në tregun e punës kanë shërbyer si tregues të vlerësimit të cilësisë të studentëve. - Rekomandojmë të hartohet në të ardhmen raporte periodike analitike mbi shkallën e cilësisë së punësimit të studentëve, mbi profilin në cilësi në hyrje dhe dalje, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. <i>Evidencë 6.6 Raporti i cilësisë së studentëve</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson në tërësi pozitiv KPT për mbledhjen, administrimin, përditësimin dhe ruajtjen të dhënave në lidhje me numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas evidences së Stautit të KPT, ky institucion ka në përbërje Këshillin e Studentëve. Ky këshill është pjesëmarrës në qeverisjen e KPT me përfaqësi nga studentët e saj. Këshilli është i organizuar në mënyrtë pavaruar nga KPT, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët duke përfaqësuar interes të tyre. Detyra e tij ishte të realizonte dhe mundësonte pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinimin e përfaqësuesve të tyre në qeverisjen e KPT. Ky këshill kishte të drejtë të shprehte dhe të propozonte mendime në lidhje me aktivitetin mësimor të KPT. Bazuar në statut Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 vjet nga votat e të gjithë studentëve me një përfaqësues për çdo program studimi. <i>Evidencë 3 Statuti i KPT</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga vizita në institucion na u pohua se pjesëmarrja e studentëve në Këshillin Studentor ishte reale, konkrete dhe frutdhënëse me rezultate të matshme në aktivitetin e përgjithshëm të KPT. Kjo gjë është realizuar nëpërmjet propozimeve dhe mendimeve të dhëna nga KSh në interes të përgjithshëm të institucionit. Këto propozime dhe mendime përfshijnë planet për programet e studimeve, rregulloret dhe veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, ndarjen dhe menaxhimin e burimeve financiare, zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, artisitke dhe sportive etj. Nga pyetjet që patëm gjatë vizitës në institucion, na u komunikua që studentët bënin vlerësim anonim për pedagogët me të cilët kanë zhvilluar mësim, me qëllim rritjen e performances dhe cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu na u tha që edhe Departamenti kryen mbledhje të hapura me pedagogë dhe student bashkarisht për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve dhe për të shprehur të gjitha mendimet dhe problematikat nga studentët. <i>Evidencë 3 Statuti i KPT</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse	Sipas statutit të KPT të paraqitur në evidence, në kuadër të

garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	mbarëvajtjes së cilësisë së programeve institucioni merr mendimin e studentëve nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse, të tilla si: Senati, NJSBC, Këshilli Studentor. Këto organe përdorin metoda vlerësimi si për shembull mbledhjet, focus grupet, sondazhet dhe intervistat e studentëve me qëllim rritjen e cilësisë dhe përmirësimit të programeve të studimit. Departamenti, si njësi përgjegjëse, garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Sugjerimet dhe mendimet e studentëve reflektohen në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. <i>Evidencë 15 formularët e vlerësimit të studentëve</i> <i>Evidencë 16 Fokus Grupet</i> <i>Evidencë 17 tutoriatet</i> <i>Evidencë 6.4 Anketa e Stafit</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Nga shqyrtimi i rregullores së KPT të paraqitur në evidencë, studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është shprehur gjithashtu në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi. Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogët dhe zhvillimi i seancave sqaruese për të patur edhe mundësi rivlerësimi i vlerësimeve dhe konsiderojmë si tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e tyre sipas Formularit të Kërkesës së paraqitur në evidencë. Ecuria e procedurës së ndjekur shprehet në rregulloren e KPT. <i>Evidencë 15 formularët e vlerësimit të studentëve</i> <i>Evidencë 6.4 Anketa e Stafit</i> <i>Evidencë 5 Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidencë 42 Formular i Kërkesës</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet pozitiv mbi standardin V.5 ku Kolegji Profesional I Tiranës ka përfshirë dhe angazhuar studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit "Teknologji Ndërtimi", metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe shqyrtimit të dokumentacionit në evidenca, KPT ka organizuar procedura dhe njësi të veçanta në shërbim të informimit të studentëve. Orientimi dhe këshillimi i studentëve ishte i ndarë në dy faza: - Orientimi dhe këshillimi për maturantët që duan të ndjekin studimet në KPT - Orientimi dhe këshillimi për studentët gjatë kohës së studimit në KPT. Vlerësojmë zyrën e Karrierës Informacionit dhe Mbështetjes dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore mbi orientimin dhe këshillimin juridik dhe insitucional të studnetëve gjatë ndjekies së studimeve në KPT. Gjithashtu, vlerësojmë organizimin që KPT ka bërë për sa i përket Javës Orientuese, ku i gjithë stafi administrativ dhe akademik viheshin në dispozicion të studentëve për orientim, këshillim dhe dhënie e çdo informacioni në lidhje me programet e studimit dhe funksionimin e KPT. Në ndihmë të tyre na u komunikua që është edhe zyra e IT, me shpërndarjen e informacioneve në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale. <i>Evidencë 24 Politika e komunikimit</i> <i>Evidencë 24/2 Open Days</i> <i>Evidencë 30 Java e orientimit</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Vlerësojmë përpjekjet e KPT mbi ofrimin e shërbimit të tutoriatit dhe këshillimit akademik të studentëve, me synim njohjen e tyre me detyrimet akademike, programet e studimit, të evidentojë në kohë vështirësitë dhe problemet e mundshme si edhe marrjen e masave për zgjidhjen e tyre. Na u komunikua që ky tutoriat funksionon gjithë vitin akademik, sipas semestrave dhe orareve të përshtatshme për pedagogët dhe studentët, në përputhje me rregulloren e tuotriatit. Gjithashtu, KPT ofronte edhe seanca konsultuese për çdo lëndë para provimit përfundimtar nga lektori i lëndës. Brenda javës nga momenti i daljes së rezultateve të provimit për çdo provim caktohej një orar për seancë sqaruese.

	Studenti në rast se ka kontestim në lidhje me rezultatin e provimit, sqarohet nga pedagogu u lëndës. Gjithashtu, sipas evidences së Formular Kerkese, student ankohet në strukturat përkatëse të KPT, në rast se e ndjen të nevojshme. <i>Evidencë 17/ rregullorja e Tutoriatit</i> <i>Evidencë 42 Formular Kërkese</i> <i>Evidencë 41 Emaillet njoftuese nga koordinatorët</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	KPT në organigramën e saj ka në përbërje Zyrën e Karrierës, Informacionit dhe Mbshtetjes së Studentëve, e cila luan një rol thelbësor në shërbimin e këshillimit të karrierës. Sipas komunikimit me studentin gjatë takimit në institucion, kjo zyrë ndihmon në këshillimin e karrierës jo vetëm për studentët e programit të studimit me karakter profesional “Teknologji Ndërtimi”, por për të gjithë studentët e KPT. Këshillimi është në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Gjithashtu, për të lehtësuar këtë proces, kjo zyrë bashkepunon me Departamentin përkatës për organizimin e praktikave profesionale, si edhe për të krijuar ura të forta lidhjeje dhe lehtësimin në integrimin në tregun e punës së studentëve. <i>Evidencë 3 Staituti i KPT</i> <i>Evidencë 18.1 panairi I Punës</i> <i>Evidencë 21 Trajnime</i> <i>Evidencë 4 Rregullorja e KPT</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Sipas takimeve që patem me përfaqësues të Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve, na u pohua se kjo zyrë mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e punësimit të tyre. Zyra e Karrierës mbante një database të sakte dhe të detajuar me të dhënat e çdo studenti të diplomuar në lidhje me punësimin e tyre. Gjithashtu pamë që mbante dhe përpunonte statistika dhe gjeneronte raporte në lidhje me to. Vlerësojmë mbajtjen e kontakteve me bizneset për sigurimin e zhvillimit të praktikave profesionale, si edhe përpjekjet për të mundësuar marrëveshje të reja me institucione publike, private, organizata dhe kompani gjatë takimeve në panairë të ndryshme. <i>Evidencë 3 Staituti i KPT</i>

	<i>Evidencë 18.1 panairi i Punës</i> <i>Evidencë 21 Trajnime</i> <i>Evidencë 4 Rregullorja e KPT</i> <i>Evidencë 12 Sondazh Alumni</i> <i>Evidencë 12.2 Punësimi I Studentëve</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet e Institucionit për ngritjen e procedurave dhe njësive të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin dhe ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët e programit "Teknologji Ndërtimi".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Teknologji Ndërtimi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”

Pika të forta dhe afirmime:

1. Profili i studimit i nevojshëm për tregun e punës.
2. Përfshirja e ‘Tutoriatit’ për këshillimin akademik gjatë procesit mësimor i ndihmon studentët të jenë lehtësisht të orientuar.
3. Programi i studimit është i orientuar në aspekte praktike dhe aplikative, duke kontribuar në plotësimin e nevojave të tregut me specialistë të nivelit bazë në këtë fushë.
4. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si klasa, laboratorë, të pajisura me kompjutera, projektor, lidhje interneti të përshtatshme për nevojat e zhvillimit të orëve mësimore të programit të studimit “Teknologji Ndërtimi”.

Pika të dobëta:

2. Personeli akademik efektiv që mbulon ngarkesën mësimore të lëndëve karakterizuese është i ulët të numër. (Standardi II2 kriteri 2)
3. Mungon personeli akademik ndihmës në zhvillimin e praktikave dhe laboratoreve. (Standardi IV1 kriteri 5)
4. Bibliotekë e kufizuar si nga ana funksionale, ashtu edhe nga ana e përmbajtjes së literaturës bazë e ndihmëse për çdo lëndë, specifikisht për programin “Teknologji Ndërtimi”. (Standardi IV3 kriteri 7)

Rekomandime:

1. Institucioni të ketë në vëmendje të vazhdueshme rekrutimin e stafik akademik efektiv, vecanërisht të kualifikuar në mësimdhënien e lëndëve karakterizuese të programit të studimit.
2. Rekomandohet angazhimi i personelit ndihmës akademik, si personel i nevojshëm vecanërisht për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve.
3. Rekomandohet zhvillimi më i gjerë i fushatave njohëse dhe promovuese për programin e studimit, hartimi dhe promovimi i politikave të bursave për të rritur numrin e studentëve.
4. Rekomandohet një analizë periodike e DEMSA mbi nevojën e fuqizimit të bibliotekës si nga ana funksionale, ashtu edhe nga ana e pasurimit me literaturën bazë e ndihmëse për çdo lëndë, specifikisht për programin “Teknologji Ndërtimi”.

Evaluation's conclusions for the professional study program "Geodesy" provided by the Higher Education Institution " Kolegji Profesional i Tiranës"

Strengths and affirmations:

1. The profile of the study program is unique and necessary for the labor market.
2. Offering the 'Tutoriat' academic advising service during the educational process helps students be easily oriented.
3. The study program is oriented toward practical and applied aspects, contributing to the need for basic-level specialists in the field to meet market needs.
4. The institution provides sufficient and appropriate environments for the development of educational activities, such as classrooms, and laboratories, all equipped with computers, projectors, and internet connections, suitable for the needs of the study program teaching process.

Weaknesses:

1. The effective academic staff covering the teaching load of characteristic subjects is low in number.
2. There is a lack of assisting academic staff.
3. The library is limited in both functionality and the availability of primary and secondary literature for each course, particularly for the "Construction Technology" program.

Recommendation:

1. The institution should constantly pay attention to recruiting effective academic staff, especially those qualified to teach the characteristic subjects of the study program curricula.
2. The engagement of assisting academic staff is recommended as a needed staff for implementing laboratory hours and lab maintenance.
3. Developing wider awareness and promotional campaigns for the study program and promoting scholarship policies/opportunities to increase the number of students in the study program.
4. DEMSA is recommended to draft a periodical analysis on the need to strengthen the library both functionally and in terms of enrichment with main and secondary literature for each course, especially for the "Construction technology

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X